


Tirana Bank sh.a.



Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më
31 dhjetor 2013



PERMBAJTJE	III
INFORMACION I PËRGJITHSHËM	V
RAPORTI I AUDITUESIT	V
PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBYES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA GJITHPËRFSHIRËSE	3
PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR	4
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL	5
PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE	6
1 INFORMACIONI MBI SHOQËRINË	7
2 PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE TË RËNDËSISHME KONTABËL	7
2.1 BAZAT E PËRGATITJES	7
2. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KONTABËL (VAZHDIM)	8
2.1 BAZAT E PËRGATITJES (VAZHDIM)	8
2.2 KONVERTIMI I MONEDHËS SË HUAJ	9
2.3 INSTRUMENTET FINANCIARE – NJOHJA FILLESTARE DHE MATJA E MËPASHME	10
2.3 INSTRUMENTET FINANCIARE – NJOHJA FILLESTARE DHE MATJA E MËPASHME (VAZHDIM)	11
2.3 INSTRUMENTET FINANCIARE – NJOHJA FILLESTARE DHE MATJA E MËPASHME (VAZHDIM)	12
2.4 MARRËVESHJET E RIBLERJES DHE MARRËVESHJET E ANASJELLA TË RIBLERJES	12
2.4 MARRËVESHJET E RIBLERJES DHE MARRËVESHJET E ANASJELLA TË RIBLERJES (VAZHDIM)	13
2.5 PËRCAKTIMI I VLERËS SË DREJTË	12
2.6 ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE FINANCIARE	13
2.6 ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE FINANCIARE (VAZHDIM)	15
2.7 QIRAJA	15
2.8 NJOHJA E TË ARDHURAVE	16
2.8 NJOHJA E TË ARDHURAVE (VAZHDIM)	17
2.9. MJETET MONETARE DHE EKUIVALENTËT E TYRE	17
2.10 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE	17
2.11 AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE	18
2.12 ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE JOFINANCIARE	18
2.12. ZHVLERËSIMI I AKTIVEVE JOFINANCIARE (VAZHDIM) ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.	
2.13 KONTRATAT E GARANCISË FINANCIARE	18
2.14 PENSIONET DHE PËRFITIMET E TJERA PAS PUNËSIMIT	19
2.15 PROVIGJIONET	19
2.16 TATIMI MBI FITIMIN	19
2.17 INFORMACIONI KRAHASUES	20
3 MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR	20
3.1 RISKU I KREDISË	21
3 MENAXHIMI I RISKUT FINANCIAR (VAZHDIM)	21
3.1.1 MATJA E RISKUT TË KREDISË	22
3.1.1 MATJA E RISKUT TË KREDISË (VAZHDIM) ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.	
3.1.2 KONTROLLI I KUFIRIT TË RISKUT DHE POLITIKAT E SHMANGIES	24
3.1.2 KONTROLLI I KUFIRIT TË RISKUT DHE POLITIKAT E SHMANGIES (VAZHDIM)	25
3.1.3 POLITIKAT E ZHVLERËSIMIT DHE PROVIGJIONIMIT	25
3.1.4 EKSPozIMI MAKSIMAL NDAJ RISKUT TË KREDISË PA MARRË PARASYSH KOLATERALIN DHE SIGURI TË TJERA TË KREDISË	27
3.1.5 KREDITË DHE PARADHËNIET	28
3.1.6 KREDITË DHE PARADHËNIET E RI-NEGOCIUARA	32
3.1.7 KOLATERALI I RIMARRË	32
3.1.8 MJETE MONETARE DHE GJENDJE ME BANKËN QENDRORE	32
3.1.9 INSTRUMENTET E BORXHIT, BONOT E THESARIT DHE INSTRUMENTE TË TJERË	32
3.1.10 PËRQËNDRIMI I RISKUT NË AKTIVET FINANCIARE TË EKSPozUARA NË RISK KREDITI	33
3.2 RISKU I TREGUT	33
3.2.1 RISKU I KURSIT TË KËMBIMIT	33
3.2.1 RISKU I KURSIT TË KËMBIMIT (VAZHDIM)	34
3.2.1 RISKU I KURSIT TË KËMBIMIT (VAZHDIM)	35



3.2.2	RISKU I NORMËS SË INTERESIT	35
3.2.2	RISKU I NORMËS SË INTERESIT (VAZHDIM)	36
3.2.2	RISKU I NORMËS SË INTERESIT (VAZHDIM)	37
3.3	RISKU I LIKUIDITETIT	37
3.3.1	PROÇESI I MENAXHIMIT TË RISKUT	38
3.3	RISKU I LIKUIDITETIT (VAZHDIM)	39
3.3.1	PROÇESI I MENAXHIMIT TË RISKUT (VAZHDIM)	39
3.3	RISKU I LIKUIDITETIT (VAZHDIM)	40
3.3.1	PROÇESI I MENAXHIMIT TË RISKUT (VAZHDIM)	40
3.3	RISKU I LIKUIDITETIT (VAZHDIM)	41
3.3.2	ZËRAT JASHTË BILANCIT	41
3.4	VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE	42
3.4	VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE(VAZHDIM)	43
3.4	VLERA E DREJTË E AKTIVEVE DHE DETYRIMEVE FINANCIARE(VAZHDIM)	44
3.5	MENAXHIMI I KAPITALI (VAZHDIM)	ERROR! BOOKMARK NOT DEFINED.
4	VLERËSIME DHE GJYKIME TË RËNDËSISHME KONTABËL	46
6	TË ARDHURA NGA INTERESI DHE TË NGJASHME	51
7	SHPENZIME INTERESI DHE TË NGJASHME	51
8	TË ARDHURA NGA TARIFAT DHE KOMISIONET, NETO	51
9	FITIME TË TJERA	52
10	TË ARDHURA TË TJERA OPERATIVE	52
11	SHPENZIME PËR PERSONELIN	52
12	SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE	53
13	SHPENZIME TË TATIM-FITIMIT	53
13	SHPENZIME TË TATIM-FITIMIT (VAZHDIM)	54
13	SHPENZIME TË TATIM-FITIMIT (VAZHDIM)	55
14	MJETE MONETARE DHE GJENDJE ME BANKËN QENDRORE	55
15	KREDI DHE PARADHËNIE PËR BANKAT	57
16	KREDI DHE PARADHËNIE PËR KLIENTËT	58
17	AKTIVE FINANCIARE TË DISPONUESHME PËR SHITJE	60
18	AKTIVE FINANCIARE TË MBAJTURA DERI NË MATURIM	61
19	AKTIVE AFATGJATA JOMATERIALE	62
20	AKTIVE AFATGJATA MATERIALE (VAZHDIM)	63
21	AKTIVE TË TJERA	64
22	DETYRIME PËR BANKAT	65
23	DETYRIME PËR KLIENTËT	65
24	DETYRIME TË TJERA	66
25	PROVIGJIONE	66
26	KAPITALI I PAGUAR DHE PRIMI I AKSIONEVE	67
27	REZERVA TË TJERA	68
28	DIVIDENDI	68
29	MJETE MONETARE DHE EKUIVALENTËT E TYRE	68
30	PALËT E LIDHURA	69
31	PARAQITJA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE SIPAS KATEGORIVE TË MATJES	70
31	PARAQITJA E INSTRUMENTEVE FINANCIARE SIPAS KATEGORIVE TË MATJES (VAZHDIM)	71
32	NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT	71

Tirana Bank sh.a.

Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013



INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Bordi i Drejtorëve gjatë vitit 2013

Ilias Milis (Kryetar i Bordit)
Georgios Papaioannou
Bedri Collaku
Georgios Mantakas
Georgios Pouloupoulos
Georgios Charalampakis
Vasileios Koutentakis

Zyrat e regjistruara

Rr. Ibrahim Rugova, PO BOX 2400/1
Tirana, Albania

Audituesi

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k
Blvd. Dëshmorët e Kombit
Kullat binjake, kulla 1, kati 10
Tiranë, Shqipëri
Telefon +355 42 242254/280423
Faks +355 42 241639

RAPORTI I AUDITUESIT





Raport i audituesit të pavarur

Për Aksionerët dhe Bordin e Drejtorëve të Tirana Bank sh.a.

Raport për pasqyrat financiare

Ne kemi audituar pasqyrat financiare bashkëlidhur të Tirana Bank sh.a. të cilat përbëhen nga pasqyra e pozicionit financiar më 31 dhjetor 2013, pasqyra e fitimit ose humbjes dhe e të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyra e ndryshimeve në kapital dhe pasqyra e fluksit të parasë për vitin ushtrimor të mbyllur më këtë datë si dhe nga një përmbledhje e parimeve të rëndësishme të kontabilitetit dhe e shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e drejtimit për pasqyrat financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, dhe për çdo kontroll të brendshëm që drejtimi i përcakton si të rëndësishëm për përgatitjen e pasqyrave financiare pa gabime materiale, qofshin ato për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Përgjegjësia e audituesit

Përgjegjësia jonë është të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare duke u bazuar në auditimin tonë. Ne e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të zbatojmë kërkesat etike dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të përfituar siguri të arsyeshme për mungesën e gabimeve materiale në pasqyrat financiare. Një auditim përfshin kryerjen e procedurave për mbledhjen e evidencave të auditimit që mbështesin shumat dhe shënimet shpjeguese në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rrezikut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qofshin ato për shkak mashtrimesh apo gabimesh. Në kryerjen e këtyre vlerësimeve të rrezikut, audituesi merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare për të përcaktuar procedurat e auditimit që i përshtaten rrethanave, por jo për të shprehur një opinion mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të njësisë ekonomike. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin e përshtatshmërisë së parimeve të përdorura të kontabilitetit dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël të kryera nga drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se evidenca e marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të mbështetur opinionin tonë.

Opinion

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare bashkëlidhur japin një paraqitje të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, të pozicionit financiar të Tirana Bank sh.a. më 31 dhjetor 2013 si dhe të performancës së saj financiare dhe të flukseve të parasë për vitin e mbyllur më këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

Kledian Kodra, FCCA

25 qershor 2014
Tiranë, Shqipëri

Auditues Ligjor
Ekspert Kontable i Autorizuar

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Blvd. Dëshmorët e Kombit, Twin Towers, Tower 1, 10th floor, Tirana, Albania
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2241 639, www.pwc.com/al



**PASQYRA E FITIMIT OSE HUMBJES DHE E TË ARDHURAVE TË TJERA
GJITHPËRFSHIRËSE**
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

	Shënime	2013	2012
Të ardhura nga interesi dhe të ngjashme	5	4,585,088	5,627,640
Shpenzime interesi dhe të ngjashme	6	(2,940,403)	(2,769,155)
Të ardhura nga interesi, neto		1,644,685	2,858,485
Provigjioni për zhvlerësimin e kredive dhe paradhënieve	15	(1,315,316)	(1,540,112)
Të ardhura nga interesi, neto, pas provigjionit për zhvlerësimin e kredive		329,369	1,243,297
Të ardhura nga tarifat dhe komisionet	7	249,171	247,245
Shpenzime për tarifat dhe komisionet	7	(36,930)	(19,984)
Të ardhura neto nga tarifat dhe komisionet		212,241	227,261
Fitime minus humbje nga kurset e këmbimit	8	337,856	239,959
Fitime të tjera	8	(101,822)	(38,201)
Të ardhura të tjera operative	9	52,329	1,120
Shpenzime personeli	10	(579,999)	(515,199)
Shpenzime të tjera operative	11	(988,745)	(986,537)
Zhvlerësim i asetëve të marra në rrugë ligjore		(61,433)	-
Shpenzime provigjioni		(157,103)	(75,077)
Amortizimi	19, 20	(376,465)	(368,684)
Fitimi para tatimit		(1,333,772)	(196,984)
Shpenzime tatim-fitimi	12	31,290	(546)
Fitimi i vitit		(1,302,482)	(197,530)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse:			
Investime të disponueshme për shitje:			
- Fitime minus humbje gjatë vitit		176,455	57,369
- Tatim-fitimi i regjistruar drejtpërdrejtë në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse		(29,264)	(5,737)
(Humbje)/të ardhura të tjera gjithpërfshirëse të vitit		147,191	51,632
Totali i të ardhurave gjithpërfshirëse të vitit		(1,155,291)	(145,898)

Shënimet shpjeguese në faqet 7 deri 71 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi i Drejtorëve më 5 qershor 2014 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Savvas Thalassinos
Drejtore i përgjithshëm

Aleko Polo
Menaxher
Departamenti i kontrollit financiar


PASQYRA E POZICIONIT FINANCIAR
Më 31 dhjetor 2013

	Shënime	2013	2012
AKTIVE			
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	13	15,812,560	13,866,273
Kredi dhe paradhënie për bankat	14	22,870,941	13,171,181
Kredi dhe paradhënie për klientët	15	38,700,399	50,659,319
Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje	16	16,573,427	-
Aktive financiare të disponueshme për shitje	17	4,215,704	12,211,401
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	18	300,679	4,718,685
Tatim fitimi i arkëtueshëm		353,690	259,726
Aktive afatgjata jomateriale	19	869,693	401,822
Aktive afatgjata materiale	20	27,752	1,065,802
Parapagime të tatim - fitimit	12	1,654,476	25,726
Aktive të tjera	21	15,812,560	1,105,446
TOTALI I AKTIVEVE		101,379,321	97,485,381
DETYRIME DHE KAPITALI			
Detyrime për bankat	22	3,235,785	7,513,888
Detyrime për klientët	23	78,648,027	72,869,393
Detyrime të tjera	24	346,090	399,560
Provizjione	25	179,956	84,027
TOTALI I DETYRIMEVE		82,409,858	80,866,868
Kapitali			
Kapitali i paguar	26	14,754,741	11,248,500
Primi i aksioneve	26	1,735,494	1,735,494
Rezerva të tjera	27	1,641,107	1,493,916
Fitimi i mbartur		838,121	2,140,603
TOTALI I KAPITALIT		18,973,463	16,618,513
TOTALI I DETYRIMEVE DHE I KAPITALIT		101,379,321	97,485,381

Shënimet shpjeguese në faqet 7 deri 71 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi i Drejtorëve më 5 qershor 2014 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Savvas Thalassinou
Drejtor i përgjithshëm

Alcko Polo
Menaxher
Departamenti i kontrollit financiar

Tirana Bank sh.a.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)



PASQYRA E NDRYSHIMEVE NE KAPITAL

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

	Kapitali i paguar	Primi i aksioneve	Fitimi i mbartur	Rezerva të tjera	Totali i kapitalit
Më 1 janar 2012	11,248,500	1,735,494	2,338,133	1,442,284	16,764,411
Fitimi i vitit	-	-	(197,530)	-	(197,530)
Të ardhura të tjera gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Të ardhura gjithpërfshirëse për vitin	-	-	(197,530)	-	(197,530)
Kapitalizim i fitimit të mbartur në kapitalin e paguar dhe primin e aksioneve (Shënimi 25)	-	-	-	-	-
Rritje ne kapital	-	-	-	51,632	51,632
Transferim nga fitimi i mbartur në rezerva të tjera	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2012	11,248,500	1,735,494	-2,140,603	1,493,916	16,618,513
Më 1 janar 2013	11,248,500	1,735,494	2,140,603	1,493,916	16,618,513
Fitimi i vitit	-	-	(1,302,482)	-	(1,302,482)
Transferim nga aktivet financiare te disponueshme per shitje	-	-	-	147,191	147,191
Humbje gjithpërfshirëse për vitin	3,506,241	-	-	-	3,506,241
Të ardhura gjithpërfshirëse për vitin	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2013	14,754,741	1,735,494	838,121	1,641,107	18,969,463

Shënimet shpjeguese në faqet 7 deri 71 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi i Drejtorëve më 5 qershor 2014 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Savvas Thalassinos
Drejtor i përgjithshëm

Aleko Polo
Menaxher
Departamenti i kontrollit financiar



PASQYRA E FLUKSEVE MONETARE

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013


	Shënime	2013	2012
FLUKSE MONETARE NGA AKTIVITETI OPERATIV			
Fitimi para tatimit		(1,333,772)	(196,984)
Rregullime për:			
Amortizimin	19, 20	376,465	368,684
Ndryshimet në provigjionin e kredive	15	1,315,316	1,540,111
Ndryshimet neto në vlerën e drejtë të aktiveve financiare		(147,191)	(33,669)
Të ardhurat nga interesi, neto	5, 6	(1,644,685)	(2,858,485)
Zëra të tjerë jomonetarë	9, 16	3,681	75,077
		(1,430,186)	(1,105,266)
Rritje e rezervës së detyrueshme me Bankën Qendrore		(619,331)	(417,117)
Rritje e kredive dhe paradhënieve me klientët		11,871,024	2,900,657
Rritje në aktivet e tjera		(849,709)	(541,294)
Rënie në detyrimet për bankat		(4,278,103)	752,780
Rritje në detyrimet për klientët		5,708,115	3,157,771
Rritje/(rënie) në detyrimet e tjera		(219,572)	228,410
Interesa të arkëtuar		4,948,118	5,310,066
Interesa të paguar		(2,899,866)	(2,975,859)
Tatimi i paguar mbi fitimin		(40,953)	(142,424)
Paraja e gjeneruar nga aktivitetet operative		12,076,569	7,167,724
FLUKSE MONETARE NGA AKTIVITETET INVESTUESE			
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	20	(54,798)	(53,241)
Blerje e aktiveve afatgjata jomateriale	19	(79,034)	(134,710)
Hyrje nga shitja e aktiveve afatgjata materiale		(1,608)	18,500
Hyrje nga maturimi i aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje	16	-	4,489,432
Hyrje nga shitja e aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje	16	(15,526,679)	(11,624,745)
Hyrje nga aktive financiare të disponueshme për shitje	18	11,089,195	5,886,782
		(4,572,924)	2,773,132
Paraja neto e përdorur në aktivitetet investuese			
FLUKSE MONETARE NGA AKTIVITETET FINANCIARE			
Rritje e primit të aksioneve		3,506,241	-
Paraja neto (përdorur) / nga aktivitetet financiare		3,506,241	-
Rritja/(rënia) neto në mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre		11,009,886	5,749,742
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 1 janar	29	20,209,662	14,459,920
Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre më 31 dhjetor	29	31,219,548	20,209,662

Shënimet shpjeguese në faqet 7 deri 71 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare u miratuan nga Bordi i Drejtorëve më 5 qershor 2014 dhe u firmosën në emër të tij nga:

Savvas Thalassinos
Drejtore i përgjithshëm

Aleko Polo
Menaxher
Departamenti i kontrollit financiar



1 Informacioni mbi shoqërinë

Tirana Bank sh.a. ('Banka') është një institucion bankar që kryen veprimtarinë e saj në përputhje me dispozitat e Ligjit 9901, datë 14 Prill 2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", dhe Ligjit 9662, datë 18 dhjetor 2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë" i amenduar, Ligji 10481, datë 17 Nëntor 2011, si edhe me ligje të tjera të ngjashme. Sipas nenit 4 të statutit të saj, Banka ka si objekt të ekzekutojë për llogari të vetë apo për llogari të palëve të tjera, çdo veprimtari të njohur dhe të deleguar bankave nga ligji. Tirana Bank sh.a. është themeluar dhe kryen aktivitetin e saj në Shqipëri. 96.71% të aksioneve të saj zotërohen nga Piraeus Bank S.A.

Banka ka 56 degë (2010: 56) në Republikën e Shqipërisë dhe nuk kryen aktivitet jashtë saj.

Pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2012 u autorizuan për publikim nga Bordi i Drejtorëve më 29 prill 2013. Miratimi i pasqyrave financiare nga aksionerët do të kryhet në Asamblenë e Përgjithshme të Aksionetëve.

Aktiviteti kryesor

Aktiviteti kryesor i biznesit të Bankës janë veprimtaritë bankare tregtare dhe individuale në Republikën e Shqipërisë. Banka kryen veprimtarinë e saj në sajë të një licence të plotë lëshuar nga Banka Qendrore e Republikës së Shqipërisë ("Banka e Shqipërisë" ose "BSH") që prej vitit 1996.

2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël

Politikat kryesore kontabël të zbatuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare paraqiten në vijim. Këto politika janë zbatuar me konsistencë ndaj gjithë viteve të paraqitur nëqoftëse nuk është përmendur ndryshe.

2.1 Bazat e përgatitjes

Pasqyrat financiare të shoqërisë janë përgatitur bazuar në parimin e kostos historike, përveç aktiveve financiare të mbajtura për shitje dhe aktiveve financiare që maten me vlerën e drejtë nëpërmjet fitim/humbjeve për të cilat përdoret vlera e drejtë.

Pasqyrat financiare të Bankës janë përgatitur në përputhje me parimin e vijimësisë, i cili supozon që Banka do të vazhdojë të operojë për 12-mujore në vazhdim.

a) Pozicioni në grup

Piraeus Bank Group është ndikuar në mënyrë të vazhdueshme nga volatiliteti ekonomik dhe rritja e volatilitetit të tregjeve financiare globale, dhe gjithashtu është i ekspozuar ndaj rreziqeve që mund të lindin për institucione financiare të tjera, kryesisht nga kriza e borxhit të shteteve periferike të Eurozonës. Situata ekonomike në Greqi, panvarësisht përmirësimeve fiskale, mbetet akoma faktori i rrezikut kryesor në sektorin bankar në Greqi.



2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

2.1 Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Në rast të një zhvillimi negative në këtë zone, likuiditeti, cilësia e portofolit, fitueshmëria, dhe së fundmi, mjaftueshmëria e kapitalit të bankës dhe si rrjedhojë edhe e grupit mund të ndikohet në mënyrë të konsiderueshme.

Qëndrueshmëria e borxhit publik të Greqisë përbën një faktor rrezikshmërie të mëtejshëm për sistemin bankar grek. Në të njëjtën kohë, rreziku i një ngadalësimi i rritjes ekonomike globale dhe rreziku i krizës së borxhit në ekonomite periferike evropiane, i shtohen së bashkur rrezikut të jashtëm të pasigurisë.

Përfundimi i rritjes së kapitalit të Piraeus Bank Greece në qershor të 2013 rezultoi në përmirësimin e bazës së kapitalit dhe restaurimin e EBA Core Tier I në një nivel më të lartë sesa minimum i kërkuar (9%). Nga shuma totale e rritjes së kapitalit, përafërsisht € 1.4 miliard u mbuluan nga investitorë privat dhe € 7 miliard nga HFSF.

Panvarësisht pasigurive dhe rreziqeve ekzistuese në sistemin bankar grek, faktorët e mëposhtëm mbështesin ekonominë dhe për këtë arsye duhet të merren në konsideratë:

- Kompletimi i programit për rikapitalizimin e bankave sistematike.
- Disponueshmëria e kapitalit shtesë, në rast se nevojitet për rikapitalizimin e mëtejshëm të bankave greke dhe riorganizimin e sistemit bankar (shuma totale e kapitalit që është në dispozicion të HFSF për mbështetjen e sistemit bankar grek është € 50 miliard, përveç € 39 miliard që janë dhënë më parë).
- Mekanizmi i mbështetjes financiare nga Fondi Monetar Nderkombëtar dhe nga Bashkimi Europian, në kontekstin e programit të dytë të rregullimit ekonomik të Greqisë.
- Aftësia për të gjetur likuiditet nëpërmejt Euro-sistemit.
- Aplikimi i programit për rregullim ekonomik dhe observimi i përmirësimit të ekonomisë greke (p.sh. surplus fiskal fillimisht në 2013 krahasuar me deficitin në 2012, dhe surplus i llogarive rrjedhëse në 2013 pas shumë dekadave me deficit.

b) Pozicioni i Bankës

Në kushtet aktuale, qëllimi kryesor i bankës ka qënë likuiditeti dhe mjaftueshmëria e Kapitalit. Ashtu siç përmendet në shënimet 22 dhe 23, burimi kryesor i fondeve të Bankës përbëhet nga depozitat e mbledhura lokalisht nga korporatat dhe individët.

Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit të Bankës (siç përshkruhet nga BSH) më 31 dhjetor 2013 është 16.14% (2012; 7.42%) dhe është më e lartë se i përcaktuari specifikisht për Bankën nga ana e BSH prej 15%. Për më tepër, norma e likuiditetit të Bankës më 31 dhjetor 2013 ishte 38% (2012; 31%), e cila është në përputhje me nenin 71 të Rregullores së Bankës së Shqipërisë për likuiditetin, të datës 14 tetor 2009, ndryshuar me artikullin 75 të datës 26 tetor 2011 dhe artikullin 28 të datës 27 mars 2013.

Duke pasur parasysh situatën globale të fund vitit deri më 14 dhjetor 2013, data e miratimit të këtyre pasqyrave financiare, ekspozimi i Bankës ndaj personave të lidhur me Bankën është në përputhje me kërkesat rregullative dhe nuk ka tejkaluar vlerën e përcaktuar me Ligj.



2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

2.1 Bazat e përgatitjes (vazhdim)

Si rrjedhojë, supozimi i parimit të vijimësisë është aplikuar në përgatitjen e pasqyrave financiare. Drejtimi i përgatit këto pasqyra financiare në bazën e parimit të vijimësisë, e cila supozon që Banka do të vazhdojë aktivitetin e saj në një të ardhme të parashikueshme. Në mënyrë që të vlerësojë arsyeshmërinë e këtij supozimi, Drejtimi shqyrton parashikimet e flukseve monetare të ardhshme dhe mbështetjes së dhënë nga aksionarët.

Duke u bazuar në planet aktuale financiare, situatën aktuale të Bankës dhe në mbështetjen e Bankës mëmë, Drejtimi është i bindur që Banka do të jetë e aftë të vazhdojë aktivitetin në vijimësi në një të ardhme të parashikueshme, dhe për këtë arsye ky parim përdoret për përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

Deklarata e përrputshmërisë

Pasqyrat financiare të Tirana Bank sh.a. janë përgatitur në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) dhe interpretimet e publikuara nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (BSNK).

Politikat e kontabilitetit të miratuara janë konsistente me ato të vitit financiar të mëparshëm.

2.2 Konvertimi i monedhës së huaj

Pasqyrat financiare paraqiten në Lekë Shqiptar, e cila është monedha funksionale dhe raportuese e Bankës.

Transaksione dhe gjendje

Transaksionet në valutë të huaj regjistrohen fillimisht në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën e transaksionit.

Aktivet dhe detyrimet monetare në valutë të huaj janë të rivlerësuar me kursin e këmbimit në datën e raportimit. Të gjitha ndryshimet janë regjistruar si "(humbje)/fitime nga kurset e këmbimit" në fitim ose humbje. Zërat jo-monetare që janë matur me kosto historike në monedhë të huaj përkthehen duke përdorur kursin e këmbimit në datat fillestare të transaksioneve. Zërat jo-monetarë të matur me vlerë të drejtë në monedhë të huaj konvertohen duke përdorur kursin e këmbimit në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Kurset e këmbimit (lekë për njësi të monedhës së huaj) për monedhat kryesore më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 ishin si vijon:

	2013	2012
USD	101,86	105,85
EUR	140,20	139,59

a) Data e njohjes

Blerjet apo shitjet e aktiveve financiare që kërkojnë dhënie e aktiveve brenda afatit kohor të përcaktuar në përgjithësi nga rregullore apo konventë në treg, njihen në datën e tregimit, domethënë në datën në të cilën banka angazhohet të blejë apo të shesë aktivin.



2. Përmbledhje e politikave kontabël (vazhdim)

2.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme

b) Njohja fillestare e instrumenteve financiare

Klasifikimi i instrumenteve financiare në njohjen fillestare varet nga qëllimi për të cilin u blenë instrumentet financiare dhe karakteristikat e tyre. Të gjithë instrumentet financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë dhe në rast të aktiveve dhe detyrimeve financiare që nuk mbahen me vlerë të drejtë në fitim ose humbje, plus kosto transaksioni. Vlera e drejtë në njohjen fillestare evidencohet nga çmimi i transaksionit. Një fitim ose humbje në njohjen fillestare njihet vetëm nëse ka diferencë midis vlerës së drejtë dhe çmimit të transaksionit gjë e cila është e dukshme nga transaksione të tjera në treg për të njëjtin instrument financiar ose nga një metodë vlerësimi të dhënat e të cilës përfshijnë vetëm informacion nga tregje të dukshme.

Banka i klasifikon aktivet financiare në kategoritë në vijim: investime financiare të mbajtura deri në maturim, kredi dhe llogari të tjera të arkëtueshme dhe aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje. Banka nuk ka klasifikuar aktive financiare të disponueshme për shitje.


c) Aktivët financiare të mbajtura deri në maturim

Aktive financiare të mbajtura deri në maturim janë ato instrumente të cilat përmbajnë pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe kanë maturitet të përcaktuar dhe për të cilat banka ka synimin dhe aftësinë për t'i mbajtur deri në maturim. Nëse banka do të shiste një shumë jo të parëndësishme investimesh të mbajtura deri në maturim, e gjithë kategoria duhet të klasifikohet si të disponueshme për shitje.

Aktivët financiare të mbajtura deri në maturim maten më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, duke zbritur provigjionin e zhvlerësimit. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim në blerje si edhe komisione të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Amortizimi përfshihet në "Të ardhura interesi dhe të ngjashme" në fitim ose humbje. Humbjet që rezultojnë nga zhvlerësimi i këtyre investimeve njihen në fitim ose humbje si "Humbje nga zhvlerësimi i instrumenteve financiare", nëse ka.

d) Kredi dhe llogari të tjera të arkëtueshme

Kredi dhe llogari të tjera të arkëtueshme përfshin "Kredi për bankat" dhe "Kredi dhe paradhënie për klientët", të cilat janë aktive financiare me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitet të përcaktuar që nuk janë të kuotuar në një treg aktiv. Ato nuk krijohen me synimin e rishitjes së menjëhershme apo afatshkurtër dhe nuk klasifikohen si "Aktive financiare të mbajtura për tregtim", të mbajtura si "Investime financiare të disponueshme për shitje" ose "Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje". Pas njohjes fillestare, shumat e këtyre kredive njihen më pas me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit, duke zbritur provigjionin për zhvlerësim. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim në blerje si edhe komisione të cilat janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit. Amortizimi përfshihet në "Të ardhura interesi dhe të ngjashme" në fitim ose humbje. Humbjet që rezultojnë nga zhvlerësimi i këtyre instrumenteve njihen në fitim ose humbje si "Humbje nga zhvlerësimi i kredive dhe paradhënieve".



2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)

e) *Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje*

Kjo kategori përfshin bono thesari të Qeverisë Shqiptare.

Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje janë aktive financiare të cilat menaxhohen dhe vlerësohen për performancë bazuar në vlerën e drejtë, në përputhje me politikën e bankës për menaxhimin e riskut. Aktivitetet financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje mbahen me vlerën e drejtë. Interesi i fituar nga aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje që llogaritet duke përdorur metodën e interesit efektiv paraqitet në pasqyrën gjithpërfshirëse të të ardhurave si të ardhura nga interesi. Të gjithë elementët e tjerë të ndryshimeve në vlerën e drejtë dhe fitimeve ose humbjeve nga çregjistrimi njihen në fitim ose humbje si të ardhura të tjera në periudhën kur ato ndodhin.

f) *Aktive financiare të disponueshme për shitje*

Ky klasifikim përfshin letra me vlerë investimi të cilat, Banka synon t'i mbajë për një periudhë të pacaktuar kohe dhe të cilat mund të shiten si përgjigje ndaj një nevojë likuiditeti apo ndryshimesh në normat e interesit, kurset e këmbimit apo çmimeve të aksioneve. Letrat me vlerë të investimit të disponueshme për shitje mbahen me vlerë të drejtë. Të ardhurat nga interesi nga instrumentet e disponueshëm për shitje llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe njihen në fitim ose humbje të vitit. Dividendët nga instrumentet e kapitalit të disponueshëm për shitje, njihen në fitim ose humbje në vitin kur përcaktohet e drejta e bankës për të marrë pagesat dhe është e mundur që dividendët do të arkëtohen. Të gjithë elementët e tjerë të ndryshimeve në vlerën e drejtë njihen në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse derisa investimi çregjistrohet apo zhvlerësohet, kohë në të cilën fitimi ose humbja e akumuluar riklasifikohet nga të ardhura të tjera gjithpërfshirëse në fitim ose humbje të vitit.

Humbjet e zhvlerësimit njihen në fitim ose humbje të vitit kur ato ndodhin si rezultat i një apo më shumë ngjarjeve (“ngjarje të humbjes”) që kanë ndodhur pas njohjes fillestare të letrave me vlerë të investimit të disponueshme për shitje. Një rënie e madhe ose një rënie e zgjatur në vlerën e drejtë deri në më pak sesa kosto e instrumentit është një tregues që ai instrument është i zhvlerësuar. Humbja e akumuluar e zhvlerësimit – e matur si diferenca midis kostonë së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus humbjet e njohura më parë në fitim ose humbje nga zhvlerësimi – riklasifikohet nga të ardhura të tjera gjithpërfshirëse në fitim ose humbje të vitit. Humbjet nga zhvlerësimi i instrumenteve të kapitalit nuk rimerren dhe çdo fitim i mëpasshëm njihet në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse. Nëse në një periudhë të mëpasshme vlera e drejtë e instrumentit të klasifikuar si i disponueshëm për shitje rritet dhe rritja është e lidhur objektivisht me një ngjarje që ndodh pas njohjes së humbjes së zhvlerësimit në fitim ose humbje, humbja e zhvlerësimit rimerret në fitim ose humbje të vitit.

g) *Detyrimet financiare*

Pas matjes fillestare, borxhi dhe huamarrjet e tjera maten me kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Nuk ka detyrime financiare të matura me



2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.3 Instrumentet financiare – njohja fillestare dhe matja e mëpasshme (vazhdim)

vlerë të drejtë në fitim ose humbje. Çdo diferencë midis arkëtimeve minus kostot e transaksionit dhe vlerës së riparimit njihet si “Shpenzime interesi dhe të ngjashme” në fitim ose humbje. Kosto e amortizuar llogaritet duke marrë parasysh çdo zbritje ose prim në emetim dhe kosto që janë pjesë integrale e normës efektive të interesit.

b) Kompensimi i instrumenteve financiare

Aktivitet dhe detyrimet financiare kompensohen dhe shuma neto paraqitet në pasqyrën e pozicionit financiar kur ekziston një e drejtë ligjore për të netuar shumat e njohura dhe ekziston synimi për shlyerje në baza kompensimi, ose për të realizuar aktivin apo shlyer detyrimin njëkohësisht.

i) Çregjistrimi

Aktivitet financiare çregjistrohen kur përfundojnë së ekzistuari të drejtat kontraktuale për të marrë flukse monetare nga aktivi, ose kur aktivi dhe të gjithë risqet dhe shpërblimet e pronësisë së tij janë transferuar (që domethënë, nëse të gjitha risqet dhe shpërblimet nuk janë transferuar tërësisht, banka teston kontrollin për t’u siguruar që përfshirja e vazhdueshme në bazë të të drejtave të mbetura nuk parandalon çregjistrimin). Detyrimet financiare çregjistrohen kur ato ripaguhën ose anulohen.

2.4 Marrëveshjet e riblerjes dhe marrëveshjet e anasjella të riblerjes

Letrat me vlerë të shitura përmes marrëveshjeve për t’i riblerë në një datë të ardhshme të specifikuar (“REPO”) nuk çregjistrohen nga pasqyra e pozicionit financiar. Arkëtimet përkatëse, duke përfshirë interesin e maturuar, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si “Detyrime për bankat”, duke pasqyruar thelbin ekonomik të kredisë bankare. Diferenca midis çmimit të shitjes dhe të riblerjes trajtohet si shpenzim interesi dhe maturohet përgjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur metodën e normës efektive të interesit. Ndërkohë letrat me vlerë të blera përmes marrëveshjeve për rishitje në një datë të ardhshme të specifikuar, marrëveshjet e anasjella të riblerjes (“Reverse REPO”), regjistrohen si detyrime për banka të tjera ose kredi dhe paradhënie për klientë, sipas rastit. Pagesat përkatëse të kryera, duke përfshirë interesin e maturuar, njihen në pasqyrën e pozicionit financiar si detyrime për bankat. Diferenca midis çmimit të blerjes dhe atij të rishitjes trajtohet si e ardhur nga interesi dhe maturohet përgjatë jetës së marrëveshjes duke përdorur metodën e normës efektive të interesit.

2.5 Përcaktimi i vlerës së drejtë

Për instrumentet financiare që tregtohen në tregje aktive, përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare bazohet në çmimet e tregut ose kuotimet e çmimit nga ndërmjetësit. Një instrument financiar konsiderohet si i kuotuar në treg aktiv nëse çmimet e kuotuar janë të gatshme dhe rregullisht të publikuara në bursë, nga ndërmjetës, grupe industrish, shërbime çmimesh dhe agjenci rregullatore, dhe ato çmime paraqesin përfaqësojnë transaksione të rregullta të vërteta që kryhen me vlera të drejta. Nëse kriteret e mësipërme nuk përmbushen, tregu konsiderohet si jo-aktiv. Tregues që tregu nuk është aktiv është kur ka një hapësirë të madhe midis ofertës dhe kërkesës ose rritje të madhe në të apo kur ka pak transaksione kohët e fundit.



2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.6. Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

provigjionit dhe kjo shumë njihet në fitim ose humbje. Kreditë së bashku me provigjionin përkatës çregjistrohen kur nuk parashikohen rimarrje të ardhshme reale dhe i gjithë kolaterali është realizuar ose i është transferuar bankës. Nëse, në një vit të mëpasshëm, shuma e vlerësuar e humbjes së zhvlerësimit rritet si pasojë e një ngjarjeje të ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit, humbja e zhvlerësimit e njohur më parë rritet ose zvogëlohet në llogarinë e provigjionit. Kur rimerret një çregjistrim i mëparshëm, rimarrja kreditohet në “provigjion për zhvlerësim të kredive dhe paradhënieve”.

Vlera aktuale e vlerësimeve të flukseve të ardhshme monetare skontohej me normën fillestare efektive të interesit të aktivitetit financiar. Nëse një kredi ka një interes të ndryshueshëm, norma e skontimit për matjen e humbjeve të zhvlerësimit është norma aktuale e interesit. Përllogaritja e vlerësimit të flukseve të ardhshme të një aktiviteti financiar me kolateral pasqyron flukset monetare që mund të rezultojnë nga marrja e kolateralit minus kostot e marrjes dhe shitjes së tij, qoftë marrja e mundshme ose jo.

Me qëllim vlerësimin kolektiv të zhvlerësimit, aktivitetet financiare grupohen në bazë të sistemit të brendshëm të bankës për riskun e kredisë, i cili merr parasysh karakteristikat e riskut të kredisë, të llojit të aktivitetit, industrisë, llojit të kolateralit, ditë-vonesat dhe faktorë të tjerë të përshatshëm. Flukset e ardhshme monetare nga një grup aktivitetesh financiare vlerësohen kolektivisht për zhvlerësim duke u bazuar në eksperiencën historike të humbjeve të aktiveve me karakteristika risku të ngjashme me ato në grup. Eksperiencën historike e humbjeve, rregullohet në bazë të të dhënave të dukshme për të pasqyruar ndikimet e kushteve që nuk ndikuan vitet në të cilat bazohet eksperiencën historike e humbjeve, për të përjashtuar ndikimet e kushteve në periudhën historike të cilat nuk ekzistojnë aktualisht. Vlerësimet e ndryshimeve në flukset e ardhshme monetare pasqyrojnë dhe janë konsistente me ndryshimet në të dhënat e dukshme nga viti në vit (ndryshime të tilla si normat e papunësisë, çmimet e pasurive, gjendja e pagesave apo faktorë të tjerë tregues të humbjeve në grup, dhe shtrirja e tyre). Metodologjia dhe supozimet e përdorura për vlerësimin e flukseve të ardhshme monetare rishikohen rregullisht për të zvogëluar çdo diferencë ndërmjet vlerësimit të humbjes dhe eksperiencës faktike.

b) *Aktivitetet financiare të mbajtura deri në maturim*

Banka vlerëson individualisht evidencën objektive të zhvlerësimit në rastin e investimeve të mbajtura deri në maturim. Nëse ka evidencë objektive që ka ndodhur një humbje zhvlerësimi, shuma e humbjes matet si diferencë midis vlerës së mbetur të aktivitetit dhe vlerës aktuale të vlerësimeve të flukseve të ardhshme monetare. Vlera e mbetur e aktivitetit reduktohet dhe shuma e humbjes njihet në fitim ose humbje.

Nëse në vitet e mëpasshme shuma e vlerësuar e humbjes nga zhvlerësimi zvogëlohet si pasojë e një ngjarjeje të ndodhur pas njohjes së zhvlerësimit, çdo shumë e debituar më parë, kreditohet në “Humbje nga zhvlerësimi i aktiveve financiare”.

c) *Aktive financiare të disponueshme për shitje*

Banka vlerëson nëse ekziston evidencë objektive që një aktiv financiar apo grup aktivitetesh financiare janë zhvlerësuar në çdo datë raportimi. Në rastin e investimeve në borxh të klasifikuara si të disponueshme për shitje, një rënie e rëndësishme dhe e zgjatur në vlerën e drejtë të instrumentit nën koston e tij, merret parasysh në përcaktimin e zhvlerësimit ose jo



2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.6 Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)

të aktivitetit. Në rast se ekziston evidencë e tillë, aktivitetet financiare të disponueshme për shitje, humbja e akumuluar – e matur si diferencë midis kostos së blerjes dhe vlerës së drejtë aktuale, minus çdo humbje zhvlerësimi të njohur më parë në fitim ose humbje ndaj atij aktiviteti financiar – çregjistrohet nga të ardhurat të tjera gjithëpërfshirëse dhe njihet në fitim ose humbje. Nëse në periudhat e mëpasshme, vlera e drejtë e një instrumenti borxhi të klasifikuar si i disponueshëm për shitje rritet, dhe rritja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur, pasi humbja e zhvlerësimit është njohur në fitim ose humbje, humbja e zhvlerësimit do të rimerrret nëpërmjet fitimit ose humbjes.

d) Kreditë e ri-negociuara

Kur është e mundur, banka mundohet të ristrukturojë një kredi në vend që të marrë kolateralin. Kjo mund të përfshijë shtyrjen e marrëveshjeve të ripagesës dhe një marrëveshje të re për kushtet e kredisë. Me ri-negocimin e kushteve, kredia nuk konsiderohet më në vonesë. Menaxhimi rishikon vazhdimisht kreditë e ri-negociuara për t'u siguruar që të gjitha kriteret përmbushen dhe pagesat e ardhshme kanë mundësi të kryhen. Kreditë vazhdojnë të jenë subjekt i një vlerësimi individual apo kolektiv për zhvlerësim, të llogaritur duke përdorur normën efektive fillestare të interesit të kredisë.

2.7 Qiraja

Përcaktimi nëse një marrëveshje është ose përmban një qira, bazohet në thelbin e marrëveshjes e cila kërkon një vlerësim nëse përmbushja e marrëveshjes është në varësi të përdorimit të aktivitetit apo aktiveve specifike dhe marrëveshja transferon një të drejtë për të përdorur aktivin.

(i) Banka si qiramarrës

Qiratë financiare, të cilat i transferojnë bankës në thelb të gjitha risqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e objektit të qirasë, kapitalizohen me fillimin e afatit të qirasë me vlerën e drejtë të pasurisë së marrë me qira ose, kur është më e vogël, me vlerën e drejtë të pagesave minimale të qirasë dhe përfshihen në "Aktive afatgjata materiale", me detyrimin përkatës ndaj qiradhënësit të përfshirë në "Detyrime të tjera". Pagesat e qirasë ndahen midis shpenzimit financiar dhe detyrimit të qirasë për të arritur një normë konstante interesi mbi gjendjen e mbetur të detyrimit. Shpenzimet financiare regjistrohen drejtpërdrejt kundrejt të ardhurave në "Shpenzime interesi dhe të ngjashme". Banka nuk kishte marrëveshje të rëndësishme qiraje financiare gjatë periudhës së raportimit.

Aktivitetet e kapitalizuara të qirasë amortizohen përgjatë kohës më të shkurtër midis jetës së dobishme të vlerësuar të aktivitetit dhe afatit të qirasë, nëse nuk ka siguri të arsyeshme që banka do të marrë pronësinë e objektit në fund të afatit të qirasë. Detyrimet e pagesave të qirasë së zakonshme kontabilizohen në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë dhe përfshihen në "Shpenzime të tjera operative". Kur një qira e zakonshme përfundon para se afati i qirasë të ketë përfunduar, çdo pagesë e kërkuar nga qiradhënësi si penalitet njihet si shpenzim në periudhën kur përfundimi ka ndodhur.



2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.7. Qiraja (vazhdim)

(ii) Banka si qiradhënëse

Kur banka është qiradhënëse në një qira e cila në thelb nuk transferon të gjitha risqet dhe përfitimet e pronësisë nga banka tek qiramarrësi, totali i pagesave të qirasë njihet në fitim ose humbje të vitit (të ardhura nga qiraja – shënimi 2.9) në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë.

2.8 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat njihen në masën që është e mundur që përfitimet ekonomike mund të maten në mënyrë të besueshme. Kriteret specifike në vijim duhet të përmbushen që të ardhurat të njihen.

a) Të ardhura dhe shpenzime interesi dhe të ngjashme

Të ardhura interesi dhe të ngjashme përfshijnë kuponë të fituar nga investimet me të ardhura të pandryshueshme, zbritjen e maturuar dhe primin nga bonot e thesarit dhe të ardhura interesi nga kredi dhe paradhënie. Për të gjithë instrumentet financiare të matur me kosto të amortizuar dhe instrumentet financiare të klasifikuar si të disponueshëm për shitje që bartin interes, të ardhura ose shpenzime interesi regjistrohet me normën efektive të interesit, e cila është norma që barazon vlerën aktuale të pagesave ose arkëtimit monetare të ardhshme përgjatë jetës së instrumentit financiar, ose një periudhë më të shkurtër, sipas rastit, me vlerën e mbetur neto të aktivitetit ose detyrimit financiar.

a) Interest and similar income and expense (continued)

Përlllogaritja merr parasysh të gjitha kushtet kontraktuale të instrumentit financiar (për shembull, mundësitë e parapagimit) dhe përfshin çdo tarifë ose kosto rritëse që lidhet direkt me instrumentin dhe janë pjesë përbërëse e normës efektive të interesit, por përjashton humbjet e ardhshme të kredisë. Vlera e mbetur e aktivitetit ose detyrimit financiar rregullohet nëse banka rishikon vlerësimet e saj të pagesave dhe arkëtimit. Vlera e mbetur e rregulluar llogaritet duke u bazuar në normën efektive fillestare të interesit dhe ndryshimi në vlerën e mbetur regjistrohet si të ardhura ose shpenzime interesi. Sapo vlera e regjistruar e aktivitetit financiar ose e një grupi aktiveve të ngjashme financiare është reduktuar si pasojë e një humbjeje zhvlerësimi, të ardhurat nga interesi vazhdojnë të njihen duke përdorur normën efektive të interesit që përdoret kundrejt vlerës së re të mbetur.

b) Të ardhura nga tarifat dhe komisionet


Banka fiton tarifa dhe komisione nga një gamë e ndryshme shërbimesh që ajo u ofron klientëve të saj. Të ardhurat nga tarifat mund të ndahen në disa kategori:

Të ardhura nga tarifat ndaj shërbimeve që ofrohen përgjatë një periudhe të caktuar kohe

Tarifat e fituara për kryerjen e shërbimeve përgjatë një periudhe kohe maturohen përgjatë asaj periudhe. Këto tarifa përfshijnë të ardhura nga komisionet dhe menaxhimi i aktiveve, tarifa për mirëbesim dhe për menaxhim dhe këshillime të tjera. Tarifat për angazhimet e kredisë, për kredi që do të përdoren, dhe tarifa për kredi të tjera shtyhen (së bashku me kostot rritëse) dhe njihen si rregullim i normës efektive të interesit kundrejt kredisë.

Të ardhura nga tarifat për shërbime transaksioni

Tarifat që rezultojnë nga negociimi ose pjesëmarrja në negociimin e transaksioneve për një



2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.8 Njohja e të ardhurave (vazhdim)

palë të tretë – si marrëveshja e blerjes së aksioneve apo letrave të tjera me vlerë ose blerja apo shitja e bizneseve – njihen në përfundim të transaksionit përkatës. Tarifat ose pjesët përbërëse të tarifave që lidhen me një performancë të caktuar njihen pas përbushjes së kriteve përkatëse.

c) Të ardhura nga qiraja

Të ardhurat nga qiraja (shënimi 2.8) kontabilizohen në mënyrë lineare përgjatë afatit të qirasë, dhe regjistrohen në fitim ose humbje në “Të ardhura të tjera operative”. Banka nuk kishte pasuri investimi të rëndësishme në fund të vitit dhe gjatë periudhës së raportimit.

2.9. Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përfshijnë gjendjet e parasë dhe depozitat në të parë me një maturitet fillestar tre mujor ose më pak. Për pasqyrën e flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga arka, llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore dhe llogaritë në të parë me bankat e tjera dhe me maturitet fillestar tre mujor ose më pak. Rezerva e detyruar me Bankën Qendrore nuk është e disponueshme për veprimtarinë e përditshme të bankës dhe nuk përfshihet si përbërës i mjeteve monetare për pasqyrën e flukseve monetare. Mjetet monetare mbahen me kosto të amortizuara. Më shumë detaje për mjetet monetare gjenden në shënimin 29.

2.10 Aktive afatgjata materiale

Aktivet afatgjata materiale mbahen me kosto, duke përjashtuar kostot e shërbimeve të përditshme, minus amortizimin dhe zhvlerësimin e akumuluar.

Amortizimi llogaritet duke përdorur mënyrën lineare për të zvogëluar koston e aktiveve afatgjata materiale në vlerën e tyre të rikuperueshme përgjatë jetës së tyre të dobishme të vlerësuar. Toka nuk amortizohet. Jetët e dobishme të vlerësuara janë si në vijim:

- Ndërtesat: deri 20 vjet
- Mobilieri dhe pajisje të tjera: 5 vjet
- Automjete: 5 vjet
- Pajisje kompjuterike: 4 vjet
- Përmirësime të ambienteve të marra me qira: më e shkurtra midis jetës së dobishme dhe afatit të qirasë

Vlera e rikuperueshme e aktivitetit dhe jetët e dobishme rishikohen dhe rregullohen, nëse është e nevojshme, në çdo datë raportimi.

Një zë i aktiveve afatgjata materiale çregjistrohet kur aktivi shitet ose kur nuk priten më përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi apo shitja e tij. Çdo fitim ose humbje nga çregjistrimi i aktivitetit (llogaritur si diferencë midis arkëtimit neto nga shitja dhe vlerës së mbetur të aktivitetit) njihet në “Të ardhura të tjera operative” ose “Shpenzime të tjera operative” në fitim ose humbje të vitit, kur aktivi çregjistrohet.



2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.11 Aktive afatgjata jomateriale

Aktivitet afatgjata jomateriale të blera nga banka, mbahen me kosto minus amortizim dhe zhvlerësim të akumuluar, nëse ka.

Aktivitet afatgjata jomateriale përbëhen tërësisht nga programe kompjuterike të cilat kapitalizohen në bazë të kostove të nevojshme për të blerë aktivin dhe për ta sjellë atë në përdorim, dhe amortizohen përgjatë jetës së dobishme katër vjeçare në mënyrë lineare.

Amortizimi regjistrohet në fitim ose humbje nga momenti kur aktivitet janë të disponueshëm për përdorim. Kostot e mirëmbajtjes së programeve njihen si shpenzim kur ato ndodhin. Shpenzimet që përmirësojnë ose shtojnë performancën e programeve kompjuterike më shumë se specifikimet fillestare ose shpenzimet e përditësimeve të programeve, njihen si përmirësime kapitale dhe i shtohen koston fillestare, nëse mund të maten me besueshmëri.

2.12 Zhvlerësimi i aktiveve jofinanciare

Banka vlerëson në çdo datë raportimi ose më shpesh nëse ka ngjarje ose ndryshime rrethanash që tregojnë se vlera e mbetur mund të jetë e zhvlerësuar, nëse ka tregues që një aktiv jofinanciar mund të jetë i zhvlerësuar. Kur ka tregues të tillë, ose kur është i nevojshëm testimi vjetor për zhvlerësim të aktivitet, banka vlerëson shumën e rikuperueshme të aktivitet. Kur vlera e mbetur e aktivitet (ose njësisë gjeneruese të parasë) tejkalon vlerën e rikuperueshme, aktivitet (ose njësisë gjeneruese e parasë) konsiderohet i zhvlerësuar dhe regjistrohet deri në shumën e rikuperueshme.

Për aktivitet me përjashtim të emrit të mirë, në çdo datë raportimi, kryhet një vlerësim për të parë nëse ka tregues që humbjet e zhvlerësimeve të njohura më parë mund të mos ekzistojnë më ose mund të jenë zvogëluar. Nëse ekzistojnë tregues të tillë, vlerësohet shumata e rikuperueshme. Një humbje zhvlerësimi e njohur më parë rimerret, vetëm nëse ka pasur ndryshime në vlerësimet e kryera për të përcaktuar shumën e rikuperueshme të aktivitet, që nga njohja e fundit e humbjes së zhvlerësimit. Në këtë rast, vlera e mbetur e aktivitet rritet deri në shumën e rikuperueshme.

2.13 Kontratat e garancisë financiare

Kontratat e garancisë financiare kërkojnë që emetuesi të kryejë pagesa specifike për të rimbursuar mbajtësin për humbje që ai ndesh si pasojë e dështimit të një huamarrësi të caktuar në datën e detyrimit, në përputhje me kushtet e instrumentit të borxhit.

Këto garanci financiare u jepen bankave, institucioneve financiare dhe organizmave të tjera për llogarit të klientëve për të siguruar kredi, paradhënie dhe produkte të tjera bankare.

Garancitë financiare njihen fillimisht me vlerë të drejtë në datën kur garancia jepet. Pas njohjes fillestare, detyrimet e bankës në sajë të këtyre garancive maten me më të madhen midis matjes fillestare minus amortizimin e llogaritur për të njohur në fitim ose humbje tarifave të fituara në mënyrë lineare përgjatë jetës së garancisë dhe vlerësimit më të mirë të shpenzimit të kërkuar për të shlyer çdo detyrim të garancisë financiare në datën e raportimit. Këto vlerësime përcaktohen në bazë të eksperiencës me transaksione të ngjashme dhe historikut të humbjeve, të mbështetur nga gjykimi i menaxhimit. Çdo rritje në detyrim nga garancitë regjistrohet në fitim ose humbje si shpenzime të tjera operative.

Garancitë dhe angazhimet financiare për të dhënë kredi, njihen fillimisht me vlerën e drejtë, e cila evidencohet normalisht nga shumata e tarifave të marra. Kjo shumë amortizohet në mënyrë lineare përgjatë jetës së angazhimit.



2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.14 Pensionet dhe përfitimet e tjera pas punësimit

Banka paguan kontribute në planet pensionale të punonjësve të saj sipas kërkesave të legjislacionit vendas për sigurimet shoqërore. Detyrimet pensionale të bankës, lidhen vetëm me plane me kontribut të përcaktuar. Planet me kontribut të përcaktuar, të bazuar mbi pagat, bëhen me institucionin e administruar nga shteti (Instituti i Sigurimeve Shoqërore) përgjegjës për pagesën e pensioneve. Banka nuk ka detyrime të mëtejshme pas pagesës së kontributit. Kontributet përbëjnë kosto neto periodike për vitin në të cilin ato lindin dhe përfshihen në "Shpenzime personeli" në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse.

2.15 Provigjionet

Provigjionet njihen kur banka ka një detyrim aktual (ligjor apo konstruktiv) si rezultat i ngjarjeve të kaluara dhe ka shumë mundësi që të ekzistojë një dalje burimesh që kërkohet për të shlyer detyrimin; dhe shumat mund të matet me besueshmëri.

Kur ka një numër detyrimesh të ngjashme, mundësia e daljes së burimeve për shlyerje përcaktohet duke marrë në konsideratë kategorinë e detyrimit si të ishte një. Një provigjion njihet edhe nëse mundësia e daljes së burimeve në lidhje me çdo zë të përfshirë në të njëjtën kategori detyrimesh mund të jetë e vogël.

Provigjionet maten me vlerën aktuale të shpenzimeve që do të kërkohen për të shlyer detyrimin duke përdorur një normë para tatimit që reflekton vlerësimet aktuale të tregut në lidhje me vlerën në kohë të parasë dhe risqet specifike të lidhura me detyrimin. Rritja në provigjion në sajë të kalimit të kohës njihet si shpenzim interesi.

2.16 Tatimi mbi fitimin

Tatimet mbi fitimin paraqiten në pasqyrat financiare në përputhje me legjislacionin shqiptar në fuqi, në datën e raportimit. Shpenzimi i tatim-fitimit përfshin tatimin aktual dhe tatimin e shtyrë dhe njihet në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse nëse nuk është njohur në të ardhura të tjera gjithpërfshirëse kur lidhet me transaksione që njihen gjithashtu, në të njëjtën apo në një tjetër periudhë, në të ardhura gjithpërfshirëse.

Tatimi aktual

Aktivitetet dhe detyrimet aktuale tatimore për vitin në vazhdim dhe vitet e mëparshme maten me shumën që pritet të merret apo t'u paguhet autoriteteve tatimore. Normat tatimore dhe ligjet tatimore që përdoren për përlllogaritjen e shumës janë ato që janë në fuqi në datën e raportimit.

Tatimi i shtyrë

Tatimi i shtyrë llogaritet kundrejt diferencave të përkohshme midis bazave tatimore të aktiveve dhe detyrimeve dhe vlerave kontabël për raportim financiar në datën e raportimit. Detyrimet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme, përveç rasteve kur detyrimi i shtyrë tatimor rezulton nga njohja fillestare e emrit të mirë ose e një aktivi apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi dhe, në kohën e transaksionit, nuk ndikon as fitim kontabël dhe as fitimin ose humbjen e tatueshme.



2 Përmbledhje e politikave të rëndësishme kontabël (vazhdim)

2.16 Tatimi mbi fitimin (vazhdim)

Aktivitetet e shtyra tatimore njihen për të gjitha diferencat e përkohshme tatimore, kreditimet tatimore të papërdorura dhe humbjet tatimore të bartura, deri në masën që fitime të ardhshme të mundshme, kundrejt të cilave diferencat e përkohshme të zbritshme dhe kreditimet dhe humbjet tatimore të bartura mund të përdoren, do të jenë të disponueshme, përveç rasteve kur aktiviteti tatimor i shtyrë që lidhet me diferencat e përkohshme të zbritshme rezulton nga njohja fillestare e një aktiviteti apo detyrimi në një transaksion që nuk është kombinim biznesi, dhe në kohën e transaksionit, nuk ndikon fitimin kontabël apo fitim ose humbjen e tatueshme.

Vlera e mbetur e aktiveve të shtyra tatimore rishikohet në çdo datë raportimi dhe reduktohet në masën që nuk është më e mundur që të ketë fitim të tatueshëm të mjaftueshëm që të lejojë përdorimin e një pjese ose gjithë aktivitetin e shtyrë tatimor.

Aktivitetet tatimore të shtyra të panjohura rivlerësohen çdo datë raportimi dhe njihen deri në masën që bëhet e mundur të ketë fitim të tatueshëm në të ardhmen që të lejojë rimarrjen e aktivitetit të shtyrë tatimor.

Aktivitetet dhe detyrimet e shtyra tatimore maten me normat tatimore që pritet të zbatohen në vitin kur aktiviteti realizohet ose detyrimi shlyhet, duke u bazuar në normat tatimore (dhe ligjet tatimore) në fuqi në datën e raportimit.

Aktivitetet dhe detyrimet tatimore të shtyra kompensohen nëse ekziston një e drejtë e rregulluar me ligj për të netuar aktivitetin aktual tatimor kundrejt detyrimit aktual tatimor dhe tatimet e shtyra lidhen me të njëjtin autoritet tatimor.

Dividendët nga aksionet e zakonshme njihen si detyrim dhe zbriten nga kapitali kur ato miratohen nga aksionerët e bankës. Dividendët e ndërmjetëm zbriten nga kapitali kur deklarohen dhe nuk varen më nga vendimet e bankës.

Dividendët e vitit pas datës së raportimit paraqiten si ngjarje pas datës së raportimit.


2.17 Informacioni krahasues

Informacioni krahasues paraqitet me qëndrueshmëri duke përdorur politikat kontabël të bankës.

3 Menaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e bankës e ekspozojnë atë me risqe të ndryshme financiare dhe këto aktivitete përfshijnë analizën, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e një shkalle të caktuar risku apo kombinimi risqesh. Pranimi i riskut është i rëndësishëm në biznesin financiar, dhe risqet operationale janë një rrjedhojë e pashmangshme e të qenurit në biznes. Synimi i bankës është të arrijë një balancë midis riskut dhe kthimit dhe të minimizojë ndikimet e mundshme negative në performancën financiare të bankës.

Politikat e bankës për menaxhimin e riskut janë hartuar për të identifikuar risqet, për të përcaktuar kufij dhe kontrole të përshtatshme risku dhe për të monitoruar risqet dhe përputhjen me kufijtë nëpërmjet sistemeve të besueshme dhe të përditësuara të informacionit. Banka rishikon rregullisht politikat e saj të menaxhimit të riskut dhe sistemet për të pasqyruar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikat e reja më të mira. Menaxhimi i riskut kryhet nga një departament risku në bankë dhe nga politika të miratuara nga Bordi i Drejtorëve. Bordi ofron parime të shkruara për menaxhimin e



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

përgjithshëm të riskut si dhe politika të shkruara në lidhje me fusha specifike si risku i kredisë, risku i kursit të këmbimit, risku i normës së interesit dhe risku i likuiditetit.

Për më tepër, auditimi i brendshëm është përgjegjës për rishikimin e pavarur të menaxhimit të riskut dhe ambientit të kontrollit.

Llojet më të rëndësishme të riskut janë risku i kredisë, risku i likuiditetit, risku i tregut dhe risqe të tjera operationale. Risku i tregut përfshin riskun e monedhës, të normës së interesit dhe të çmimeve të tjera.

3.1 Risku i kredisë

Banka ekspozohet ndaj riskut të kredisë, i cili është risku që një palë tjetër të shkaktojë humbje financiare ndaj bankës duke dështuar përmbushjen e detyrimeve ndaj bankës. Risku i kredisë është risku më i rëndësishëm për biznesin e bankës; për këtë arsye menaxhimi drejton me kujdes ekspozimin ndaj riskut të kredisë. Ekspozimet e kredisë rezultojnë kryesisht nga aktivitetet kredidhënëse që kryesohen nga kreditë dhe paradhëniet, dhe aktivitetet e investimit që sjellin letra me vlerë të borxhit dhe letra të tjera me vlerë në portofolin e aktiveve të bankës. Edhe në instrumentet financiare jashtë bilancit ekziston risk kredie. Menaxhimi dhe kontrolli i riskut të kredisë janë centralizuar në skuadrën e menaxhimit të riskut në departamentin e riskut si në nivel lokal ashtu edhe në nivel grupi (Piraeus Bank SA) dhe i raportohen Bordit të Drejtorëve.

Objektivat kryesorë të menaxhimit të riskut të kredisë së bankës janë:

- 1) Përcaktimi i politikave dhe monitorimi i portofolit të bankës.
- 2) Menaxhimi aktiv i riskut për të identifikuar dhe analizuar herët riskun
- 3) Krijimi i funksioneve të menaxhimit të riskut të pavarura nga vija tregtare e biznesit
- 4) Integrimi i funksionit të menaxhimit të riskut në procesin e organizimit të biznesit
- 5) Raportimi për riskun përmes organizatës

Komiteti i menaxhimit të riskut të kredisë është përgjegjës për:

- Zhvillimin e sistemeve dhe infrastrukturës së menaxhimit të riskut të kredisë
- Përgatitjen e bankës për implementimin e Basel II
- Marrëdhëniet me Bankën e Shqipërisë (Banka Qendrore), Piraeus Bank dhe/ose autoritete të tjera në lidhje me efektivitetin e menaxhimit të riskut të kredisë.

Komiteti i auditimit dhe departamenti i auditimit të brendshëm ndjekin përputhshmërinë me politikat dhe procedurat.

Procedurat e përshkruara më poshtë lidhen me matjen e riskut të kredisë me qëllim operacional si dhe me raportimin sipas rregullores të Bankës së Shqipërisë. Humbjet e zhvlerësimit të kredive dhe paradhëniet për raportim financiar përcaktohen duke ndjekur procedurat e përshkruara në shënimin 3.1.3.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.1 Matja e riskut të kredisë

(a) Kredi dhe paradhënie

Në matjen e riskut të kredisë së kredive dhe paradhënieve për klientët dhe bankat në nivel palësh, banka pasqyron tre përbërës (i) 'mundësinë e dështimit' nga klienti apo palë të tjera për përmbushjen e detyrimeve; (ii) ekspozimet aktuale ndaj palës tjetër dhe zhvillimet e mundshme të ardhshme, nga të cilat banka 'ekspozohet ndaj dështimit'; dhe (iii) normën e mundshme të rimarrjes nga detyrimet e dështuara ('dështimi i kaluar në humbje').

- (i) Banka vlerëson mundësinë e dështimit të palëve individuale duke përdorur pajisje të brendshme të renditjes për kategori të ndryshme palësh. Ato janë krijuar nga vetë banka dhe kombinojnë analizë statistikore me gjykimin e oficerit të kredisë të cilat konfirmohen me të dhëna të jashtme të disponueshme, kur është e nevojshme.

Klientët e bankës segmentohen në 5 kategori. Shkalla e renditjes së bankës në vijim, pasqyron gamën e mundësive të dështimit të përcaktuar për çdo kategori. Kjo do të thotë që në parim, ekspozimet mund të lëvizin ndërmjet kategorive me ndryshimin e vlerësimit të mundësive të tyre për dështim. Pajisja e renditjes rishikohet dhe përditësohet sipas nevojës. Banka verifikon rregullisht performancën e renditjes dhe fuqinë e tyre parashikuese në lidhje me dështimet.

Shkalla e renditjes së brendshme të bankës

Renditja e bankës	Përshkrimi
A	Investim
B	Standard
C	Monitorim i veçantë
D	Nënstandard
E	Të dyshimtë dhe të humbur

Kriteri për klasifikimin e aktiveve financiare në grupet A, B, C, D dhe E janë si vijon:

Aktivitetet financiare klasifikohen në grupin **A** nëse ato u janë dhënë debitorëve të cilët vlerësohen në renditje investimi nga vlerësues të jashtëm, për shembull Moody's, S&P, Fitch, pavarësisht renditjes së brendshme. Banka nuk ka klient të tillë më 31 dhjetor 2013 dhe 2012.

Aktivitetet financiare klasifikohen në grupin **B** nëse janë kundrejt:

- Bankës së Shqipërisë dhe Qeverisë Shqiptare;
- Debitorë të cilët nuk ka mundësi dështimi dhe që ripagujnë detyrimet e tyre brenda maturitetit ose me vonesë deri në 30 ditë; dhe
- Ekspozimet e siguruara duke vendosur kolateral të renditur si kolateral i klasit të parë.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.1 Matja e riskut të kredisë (vazhdim)

Aktivitetet financiare klasifikohen në grupin **C** nëse janë kundrejt debitorësh:

- Flukset monetare të cilëve vlerësohen si të përshtatshme për të përmbushur detyrimet, pavarësisht pozicionit financiar aktual i cili vlerësohet i dobët, pa shenja të përkeqësimit të mëtejshëm në të ardhmen; dhe
- Të cilët shlyejnë detyrimet e tyre me vonesa deri në 30 ditë dhe me raste nga 31 deri 90 ditë.

Aktivitetet financiare klasifikohen në grupin **D** nëse janë kundrejt debitorësh:

- Për të cilët vlerësohet se flukset monetare nuk do të jenë të mjaftueshme për ripagesa të rregullta të detyrimeve të matura;
- Të cilët shlyejnë detyrimet e tyre me vonesa deri 90 ditë, me raste nga 91 deri 180 ditë;
- Të cilët janë dukshëm me mungesë kapitalizimi;
- Të cilët nuk kanë burime të mjaftueshme kapitali afatgjatë për të financuar investimet afatgjata; dhe
- Prej të cilëve banka nuk pret të marrë informacion aktual të kënaqshëm apo dokumentim të përshtatshëm në lidhje me ripagesat e detyrimeve.

Aktivitetet financiare klasifikohen në grupin **E** nëse janë kundrejt debitorësh:

- Për të cilët ekziston një mundësi e lartë humbjeje të një pjese të aktivitetit financiar;
 - Të cilët shlyejnë detyrimet e tyre me vonesë më shumë se 90 deri 180 ditë, me raste nga 181 deri 360 ditë;
 - Të cilët kanë paaftësi paguese;
 - Për të cilët ka filluar një lëvizje për nisje të procesit të likuidimit ose deklarimit të falimentimit e cila është në proces gjyqësor;
 - Të cilët janë në proces reformimi ose likuidimi;
 - Të cilët kanë deklaruar falimentim;
 - Prej të cilëve nuk priten ripagesa; dhe
 - Me baza ligjore të diskutueshme.
- (ii) Ekspozimi në dështim bazohet mbi shumat që banka pret të arkëtojë në kohën e dështimit. Për shembull, për një kredi është vlera nominale. Për një angazhim, banka përfshin shumën e tërhequr plus shumat e mëtejshme që mund të tërhiqen deri në kohën e dështimit, nëse ndodh.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.1 Matja e riskut të kredisë (vazhdim)

(iii) Humbjet nga dështimi apo madhësia e humbjes paraqet pritshmërinë e bankës për shtrirjen e humbjes kundrejt një ankesë nëse ndodh dështimi. Shprehet si përqindje humbjeje për njësi ekspozimi dhe ndryshon sipas llojit të palës tjetër, llojit dhe vjetërsisë së ankesës dhe disponueshmërisë së kolateralit dhe mbrojtës të tjerë të kredisë.

(b) *Letra me vlerë të borxhit dhe të tjera*

Për instrumente borxhi dhe të tjera, departamenti i riskut përdor renditje që varen nga emetuesi, Qeveria Shqiptare. Investimet në ato letra me vlerë dhe bono thesari shikohen si një mënyrë për të fituar cilësi dhe për të mbajtur në të njëjtë kohë një burim të disponueshëm për të përmbushur kërkesat për fonde.

Investimet lejohen vetëm në instrumente likuid me renditje të lartë kredie. Duke qenë se këto instrumente kanë renditje të lartë kredie, banka nuk pret që palët do të dështojnë të përmbushin detyrimet e tyre. Ekspozimi maksimal kundrejt riskut të kredisë përfaqësohet nga shuma e çdo aktivi financiar në bilanc.

3.1.2 Kontrolli i kufirit të riskut dhe politikat e shmangies

Banka menaxhon, kufizon dhe kontrollon përqendrimit e riskut të kredisë kudo që ato identifikohen – në veçanti, për palë individuale dhe grupe dhe për industri dhe vende.

Banka strukturon nivelet e riskut të kredisë që ajo ndërmerr duke vendosur kufizime mbi shumat e pranuar të riskut në lidhje me një huamarrës dhe në lidhje me segmentimet gjeografike dhe industriale. Këto risqe monitorohen rast pas rasti dhe janë subjekt i një rishikimi vjetor dhe më të shpeshtë kur është e nevojshme. Kufijtë në lidhje me nivelet e riskut të kredisë sipas produkteve dhe sektorëve të industrisë miratohen nga Bordi i Drejtorëve.

Ekspozimi ndaj riskut të kredisë menaxhohet përmes analizës së rregullt të aftësisë së huamarrësit dhe huamarrësve të mundshëm për të përmbushur detyrimet e tyre për ripagesat e interesit dhe principalit dhe duke ndryshuar kufijtë e kreditimit kur është e nevojshme.

Disa masa specifike për kontroll dhe shmangie paraqiten në vijim.

(a) *Kolaterali*

Banka zbaton një sërë politikash dhe praktikash për të zvogëluar riskun e kredisë. Më tradicionale mes tyre është marrja e siguruesve për paradhëniet si praktikë e zakonshme.

Banka zbaton udhëzime mbi pranueshmërinë e kategorive specifike të kolateralit ose shmangie të riskut të kredisë. Llojet kryesore të kolateralit për kreditë dhe paradhëniet janë:

- Paraja, garanci bankare dhe e kompanive të klasit të parë;
- Hipotekë mbi pasuritë rezidenciale;



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.2 Kontrolli i kufirit të riskut dhe politikat e shmangies (vazhdim)

- Peng mbi aktivet e biznesit si ndërtesa, inventarë, llogari të arkëtueshme; dhe
- Peng mbi instrumente financiare si instrumente borxhi dhe kapitali.

Kreditë për korporatat dhe individët janë përgjithësisht të siguruara; paradhënie dhe karta krediti për individët janë të siguruara me depozita dhe kolateral në rast klientësh kredie deri në shumën e plotë të principalit, interesave dhe shpenzimeve të tjera. Për më tepër, në mënyrë që të minimizohet humbja e kredisë, banka kërkon kolateral shtesë nga palët sapo vihen re tregues për zhvlerësim për kreditë dhe paradhëniet individuale përkatëse.

Instrumentet e borxhit, bonot e thesarit dhe instrumente të ngjashëm janë përgjithësisht të pasiguruar.

(b) Kushtëzimet e lidhura me kredinë

Qëllimi kryesorë i këtyre instrumenteve është sigurimi i fondeve për klientin sipas kërkesave. Letrat e garancisë dhe ato pezull të kredisë kanë të njëjtin risk kredie si kreditë

dhe sigurohen me po atë kolateral si kreditë. Letrat dokumentare dhe tregtare të kredisë – të cilat janë angazhime të shkruara të bankës për llogari të klientit, ku autorizohet një palë e tretë të tërheq shuma të specifikuar në bankë – kolateralizohen me dërgesën përkatëse të të mirave dhe bartin kështu më pak risk sesa një kredi e drejtpërdrejtë.

Angazhimet për të zgjeruar kredinë paraqesin pjesë të papërdorur të autorizimit për të zgjeruar kredinë në formë huaje, garancie, letra kredie. Në lidhje me riskun e kredisë mbi angazhimet për të zgjeruar kredinë, banka është e ekspozuar ndaj humbjes së shumës së barabartë me angazhimin e papërdorur.

Megjithatë, shumica e mundshme e humbjes është më e vogël se angazhimet e papërdorura, meqenëse shumë angazhime për zgjerim kredie janë të kushtëzuara në sajë të ruajtjes së standardeve specifike të kreditimit nga klientët. Banka monitoron afatin deri në maturim të angazhimit të kredisë duke qenë se angazhimet me afat më të gjatë kanë një shkallë më të lartë risku krahasuar me angazhimet afatshkurtra.

3.1.3 Politikat e zhvlerësimit dhe provigjionimit

Sistemi i brendshëm i renditjes i përshkruar në shënimin 3.1.1 fokusohet më tepër në lidhjen e cilësisë me kredinë nga pikëpamja e kreditimit dhe aktiviteteve investuese.

Ndryshe nga këto, provigjionet njihen vetëm për qëllime të raportimit financiar për humbje që janë ndeshur në datën e raportimit duke u bazuar në evidencën objektive të zhvlerësimit (shënimi 2.1(f)).

Provigjioni i zhvlerësimit i paraqitur në bilanc në fund të vitit përftohet nga secila prej kategorive të brendshme të renditjes. Megjithatë, shumica e provigjionit vjen nga dy



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.3 Politikat e zhvlerësimit dhe provigjionimit (vazhdim)

renditjet e fundit. Tabela në vijim tregon përqindjen e zërave në bilancin e bankës në lidhje me kreditë dhe paradhëniet dhe provigjionin përkatës për secilën kategori:

Renditja e bankës

	2013		2012	
	Kredi dhe paradhënie (%)	Niveli i provigjionit (%)	Kredi dhe paradhënie (%)	Niveli i provigjionit (%)
Investim	-	-	-	-
Standard	43,26	3,43	46,30	4,49
Monitorim i veçantë	14,66	4,62	21,10	9,90
Nënstandard	13,93	4,51	16,36	11,66
Të dyshimtë dhe të humbur	28,15	31,56	16,24	20,24
Totali	100.00	11,68	100.00	9.29

Pajisja e brendshme e renditjes ndihmon menaxhimin të përcaktojë nëse ekziston evidencë objektive për zhvlerësim sipas SNK 39, duke u bazuar në kriteret në vijim të vendosura nga banka:

- Vonesa në pagesat kontraktuale të principalit ose interesit;
- Vështirësi në flukse monetare për huamarrësin (raporti i kapitalit, përqindja e të ardhurave neto ndaj shitjeve);
- Shkelje e kushteve të kredisë;
- Fillimi i procedurave të falimentimit;
- Përkeqësim i pozicionit konkurrues të huamarrësit; dhe
- Përkeqësim i vlerës së kolateralit.

Politika e bankës kërkon që rishikimi i aktiveve individuale financiare që janë individualisht të rëndësishme të kryhet të paktën një herë në vit, ose më rregullisht kur kërkohet nga rrethana specifike. Provigjionet e zhvlerësimit ndaj llogarive të vlerësuara individualisht, përcaktohen rast pas rasti nga një vlerësim i humbjeve të ndodhura në datën e raportimit dhe aplikohen ndaj të gjitha llogarive të rëndësishme individualisht. Vlerësimi vendos theksin tek kolaterali i vendosur (duke përfshirë rikonfirmimin e ligjshmërisë) dhe arkëtimet e parashikuara për llogarinë individuale.

Provigjionet e vlerësuara kolektivisht për zhvlerësim kryhen për: (i) portofole me aktive homogjene të cilat nuk janë identifikuar si të rëndësishme individualisht; dhe (ii) humbje të cilat kanë ndodhur por nuk janë identifikuar ende, duke përdorur eksperiencën e disponueshme historike dhe gjykimin profesional.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.4 Ekspozimi maksimal ndaj riskut të kredisë pa marrë parasysh kolateralin dhe siguri të tjera të kredisë

	Ekspozimi maksimal	
	2013	2012
Ekspozimet e riskut të kredisë lidhur me aktivet në bilanc është si në vijim:		
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	14,153,253	12,309,366
Kredi dhe paradhënie për bankat	22,870,941	13,171,181
Kredi dhe paradhënie për klientët:		
Kreditë për individë:		
– Konsumatore/paradhënie	2,416,274	2,280,510
– Karta krediti	218,393	214,628
– Hipotekë	7,593,008	8,851,304
	<u>10,227,675</u>	<u>11,346,442</u>
Kredi për korporatat:		
– Klientë të mëdhenj	1,328,267	1,726,523
– Sipërmarrje të vogla dhe të mesme (SME)	27,144,457	37,586,354
	<u>28,472,724</u>	<u>39,312,877</u>
Totali i kredive dhe paradhënieve për klientët	<u>38,700,399</u>	<u>50,659,319</u>
Aktive financiare të disponueshme për shitje	16,573,427	12,211,401
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	4,215,704	4,718,685
<i>Ekspozimet e riskut të kredisë lidhur me aktivet jashtë bilanci është si në vijim:</i>		
Letër garancie	908,357	1,203,542
Letër kredie	37,820	39,014
Angazhime kredie	1,872,949	4,387,254
Më 31 dhjetor	<u>99,332,850</u>	<u>98,699,762</u>

Tabela më sipër paraqet skenarin më negativ të ekspozimit të riskut të kredisë për bankën më 31 dhjetor 2013 dhe 2012, pa marrë parasysh kolateralët e regjistruar apo siguruesit e tjerë të kredisë. Për aktivet në bilanc, ekspozimet e mësipërme bazohen në vlerën e mbetur të raportuar në bilanc.

Menaxhimi është i sigurt tek aftësia e tij për të vazhduar të kontrollojë dhe mbështesë ekspozimin minimal ndaj riskut të kredisë të bankës që rezulton nga portofoli i saj i kredive dhe paradhënieve dhe instrumentet e borxhit si në vijim:

- 58% e portofolit të kredive dhe paradhënieve kategorizohet në dy gradat kryesore të sistemit të brendshëm të renditjes (2012: 67%);
- Kreditë për SME, të cilat përfaqësojnë grupin më të madh në portofol, janë të mbrojtura me kolateral;
- 42% e portofolit të kredive dhe paradhënieve konsiderohen si jo në vonesë dhe as të zhvlerësuara (2012:46%);
- Banka ka filluar zbatimin e një procesi më të vështirë përzgjedhës për dhënien e kredive dhe paradhënieve; dhe
- Të gjitha investimet në instrumente borxhi dhe bono thesari janë të Qeverisë Shqiptare.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

3 Menaxhimi i riksut financiar (vazhdim)
 3.1 Risku i kredisë (vazhdim)
 3.1.5 Kreditë dhe paradhëniet



Kreditë dhe paradhëniet përmblihen si në vijim:

	31 dhjetor 2013		31 dhjetor 2012	
	Kredi dhe paradhënie për klientët	Kredi dhe paradhënie për bankat	Kredi dhe paradhënie për klientët	Kredi dhe paradhënie për bankat
Jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara	18,294,059	22,870,941	25,856,069	13,171,181
Në vonesë por jo të zhvlerësuara	10,165,120	-	6,333,059	-
Të zhvlerësuara individualisht	15,371,437	-	23,676,147	-
Bruto	43,830,616	22,870,941	55,865,275	13,171,181
Minus: provigjion për zhvlerësim	(5,130,217)	-	(5,205,956)	-
Neto	38,700,399	22,870,941	50,659,319	13,171,181

Informacion i mëtejshëm për provigjionet e zhvlerësimit për kreditë dhe paradhëniet për bankat dhe klientët paraqitet në shënimet 14 dhe 15.

Kredi dhe paradhënie jo në vonesë dhe jo të zhvlerësuara

Cilësia e kredisë së portofolit të kredive dhe paradhënieve të cilat nuk janë në vonesë dhe as të zhvlerësuara vlerësohet në bazë të sistemit të brendshëm të renditjes së bankës.

31 dhjetor 2013

Renditja	Kredi dhe paradhënie për klientët					Totali Kredi dhe paradhënie për klientët	Kredi dhe paradhënie për bankat
	Konsumatore/ paradhënie	Individuale		Korporate			
		Karta krediti	Hipotekë	Klientë të mëdhenj	SME		
Investim	-	-	-	-	-	-	-
Standard	1,936,603	126,259	5,712,099	854,360	9,721,222	18,294,059	22,870,941
Në ndjekje	-	-	-	-	-	-	-
Nënstandard	-	-	-	-	-	-	-
Të dyshimtë dhe të humbur	-	-	-	-	-	-	-
Totali	1,936,603	126,259	5,712,099	854,360	9,721,222	18,294,059	22,870,941



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.5 Kreditë dhe paradhëniet (vazhdim)

31 dhjetor 2012

Renditja	Loans and advances to customers					Totali Kredi dhe paradhënie për klientët	Kredi dhe paradhënie për bankat
	Konsumatore/ paradhënie	Individuele		Korporate			
		Karta krediti	Hipotekë	Klientë të mëdhenj	SME		
Investim	-	-	-	-	-	-	-
Në ndjekje	1,860,660	116,873	5,792,740	1,775,549	16,310,248	25,856,069	13,171,181
Monitorim i veçantë	-	-	-	-	-	-	-
Nënstandard	-	-	-	-	-	-	-
Të dyshimtë dhe të humbur	-	-	-	-	-	-	-
Totali	1,860,660	116,873	5,792,740	1,775,549	16,310,248	25,856,069	13,171,181

Kreditë dhe paradhëniet në kategoritë nënstandarde dhe të dyshimtë, u konsideruan të pazhvlërësuar pas marrjes në konsideratë të rikuperueshmërisë së kolateralit për klientët në produktet hipotekë dhe kredi konsumatore.

(a) Kredi dhe paradhënie në vonesë por jo të zhvlërësuar

Shuma bruto e kredive dhe paradhënieve që janë në vonesë por jo të zhvlërësuar:

(i) Kredi dhe paradhënie për klientët

31 dhjetor 2013

	Individuele			
	Konsumatore/ paradhënie	Hipotekë	Karta krediti	Totali
Vonesë nga 1 deri 90 ditë	310,527	1,258,333	39,857	1,608,717
Vonesë nga 91-180 ditë	67,513	243,383	6,795	317,691
Vonesë nga 181-360 ditë	-	270,770	-	270,770
Vonesë > 360 ditë	-	1,019,493	-	1,019,493
Totali	380,515	2,791,979	46,652	3,216,671
Vlera e drejtë e kolateralit	236,683	2,791,979	32,821	3,061,483

31 dhjetor 2013

	Korporata		
	SME	Klientë të mëdhenj	Totali
Vonesë nga 1 deri 90 ditë	3,604,793	3,604,793	3,604,793
Vonesë nga 91-180 ditë	3,021,315	3,021,315	3,021,315
Vonesë nga 181-360 ditë	89,196	89,196	89,196
Vonesë > 360 ditë	289,629	289,629	289,629
Totali	7,004,933	7,004,933	7,004,933
Vlera e drejtë e kolateralit	6,688,391	6,688,391	6,688,391

Totali i kredive në vonesë jo të zhvlërësuar më 31 dhjetor 2013

10,221,604



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.5 Kreditë dhe paradhëniet (vazhdim)

31 dhjetor 2012

	Paradhënie	Hipotekë	Individuale	
			Karta krediti	Totali
Vonesë nga 1 deri 90 ditë	360,543	1,446,096	34,707	1,841,346
Vonesë nga 91-180 ditë	62,845	381,310	5,243	449,398
Vonesë nga 181-360 ditë	-	390,329	-	390,329
Vonesë > 360 ditë	-	833,481	-	833,481
Totali	423,388	3,051,216	39,950	3,514,554
Vlera e drejtë e kolateralit	304,739	3,051,216	-	3,355,955

31 dhjetor 2012

	SME	Korporata	
		Klientë të mëdhenj	Totali
Vonesë nga 1 deri 90 ditë	2,182,195	-	2,182,195
Vonesë nga 91-180 ditë	213,516	-	213,516
Vonesë nga 181-360 ditë	159,426	-	159,426
Vonesë > 360 ditë	263,368	-	263,368
Totali	2,818,505	-	2,818,505
Vlera e drejtë e kolateralit	2,705,765	-	2,705,765

Totali i kredive në vonesë jo të zhvlerësuara më 31 dhjetor 2012

6,333,059

(ii) Kredi dhe paradhënie për bankat

Nuk ka kredi dhe paradhënie për bankat të cilat janë në vonesë por jo të zhvlerësuara më 31 dhjetor 2013 (2012: S'ka).

(b) Kredi dhe paradhënie të zhvlerësuara individualisht

(i) Kredi dhe paradhënie për klientët

Detajimi i shumës bruto të kredive dhe paradhënieve sipas kategorisë së bashku me vlerën e drejtë të kolateralëve përkatës të regjistruar si siguri për bankën janë si në vijim:

	Konsumatore dhe karta Visa	Korporatë		Totali
		SME	Klientë të mëdhenj	
31 dhjetor 2013				
Kredi të zhvlerësuara individualisht	577,974	14,433,506	359,957	15,371,437
Vlera e drejtë e kolateralit	-	13,347,372	307,038	13,654,410
31 dhjetor 2012				
Kredi të zhvlerësuara individualisht	517,253	23,158,894	-	23,676,147
Vlera e drejtë e kolateralit	-	21,416,167	-	21,416,167

Vlera e drejtë e paraqitur e kolateralit përcaktohet nga vlerësues vendas të çertifikuar dhe përfaqëson vlerën e realizueshme nga pronarët ligjorë të aktivit. Menaxhimi është i mendimit se kreditë e mbuluara me kolateral janë të zhvlerësuara, sepse eksperiencia ka



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.5 Kreditë dhe paradhëniet (vazhdim)

treguar që një pjesë e mirë e kolateralit të klientëve korporatë nuk mund të ekzekutohet për shkak të vështirësive administrative dhe ligjore si rënia e vlerës së kolateralit në ankandet e administruara nga zyra e përmbarimit, koha e nevojshme për ekzekutim. Provigjioni i zhvlerësimit pasqyron mundësinë që menaxhimi nuk do të jetë në gjendje të ekzekutojë të drejtat dhe të rimarrë kolateralin e kredive të dështuara. Me gjithë vështirësitë në ekzekutimin e rimarrjes së kolateralit, menaxhimi i bankës do të ndjekë me vendosmëri borxhet e papaguara me të gjitha mjetet ligjore në dispozicion.

(ii) Efekti financiar i kolateralit në provigjon

Efekti financiar i kolateralit paraqitet duke shfaqur ndikimin e kolateralit dhe zhvillime të tjera të provigjionit të kredive të njohur në fund të periudhës së raportimit. Pa mbartjen e kolateralit dhe zhvillime të tjera të kredisë, provigjioni për zhvlerësimin do të kishte efekt në prezantim me shumat e mëposhtme:

Në 2013

Kategoritë	Parapagimet Aktuale	Efekti kolateral	* Varianca
*Kredi të rëndësishme të zhvlerësuara individualisht	4,075,006	6,685,767	(2,610,761)
*Kredi të rëndësishme jo- të zhvlerësuara individualisht	373,116	373,116	-
Kredi biznesi më pak se Euro 50,000	146,489	146,489	-
Kredi Konsumatori	-	-	-
Kredi për shtëpi	424,822	424,822	-
Pasuri të paluajtëshme	56,720	56,720	-
Karta Visa	54,064	54,064	-
Totali	5,130,217	7,740,977	(2,610,761)

Në 2012

Kategoritë	Parapagimet Aktuale	Efekti kolateral	Varianca
*Kredi të rëndësishme të zhvlerësuara individualisht	4,168,961	12,773,501	(8,604,540)
*Kredi të rëndësishme jo- të zhvlerësuara individualisht	543,395	543,395	-
Kredi biznesi më pak se Euro 50,000	44,511	44,511	-
Kredi Konsumatori	161,175	161,175	-
Kredi për shtëpi	168,205	168,205	-
Pasuri të paluajtëshme	119,709	119,709	-
Karta Visa	-	-	-
Totali	5,205,955	13,810,495	(8,604,540)

(iii) Kredi dhe paradhënie bankare

Nuk ka kredi dhe paradhënie për bankat që janë individualisht të zhvlerësuara më 31 dhjetor 2013 dhe 2012.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.6 Kreditë dhe paradhëniet e ri-negociuara

Aktivitetet e ristrukturimit përfshijnë zgjatjen e marrëveshjeve të pagesës, modifikimin dhe shtyrjen e pagesave. Llogaria e një klienti më parë në vonesë, vendoset në gjendje normale pas ristrukturimit dhe menaxhohet bashkë me llogari të tjera të ngjashme. Politikat dhe praktikat e ristrukturimit bazohen në tregues ose kritere të cilat, sipas gjykimit të menaxhimit të bankës, tregojnë që ka shumë mundësi që pagesa të vazhdojë. Këto politika rishikohen vazhdimisht. Gjatë vitit 2013 kishte 153 kredi të ristrukturuara ose 4,530,228 mijë Lekë (gjatë vitit 2012 ishin 75 kredi të ristrukturuara ose 2,274,094 mijë Lekë) të detajuara sipas tabelës në vijim.

	2013		2012	
	Gjendja e mbetur	Numri i kredive	Gjendja e mbetur	Numri i kredive
Konsumatore	42,786	31	23,086	15
Hipotekë	313,585	75	106,798	25
SME	289,712	21	401,636	22
Korporatë	3,875,145	26	1,742,574	13
Totali	4,530,228	153	2,274,094	75

3.1.7 Kolaterali i rimarrë

Kolaterali i marrë pas procesit gjyqësor përfshin tokë, ndërtesa dhe ambiente biznesi të cilat nuk përdoren nga banka për veprimtarinë e saj kryesore. Kolateralët e marrë pas procesit të përmbarrimit, duhet të shiten sa më shpejtë të jetë e mundur dhe arkëtimet do të përdoren për reduktimin e borxhit të mbetur. Gjatë vitit 2013, banka mori aktive nëpërmjet marrjes së pronësisë së kolateralit në shumën 678,701 mijë Lekë (2012: 538,148 mijë Lekë).

3.1.8 Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore

Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012, shumat me Bankën Qendrore dhe me bankat korrespondente nuk ishin në vonesë dhe nuk ishin të zhvlerësuar.

3.1.9 Instrumentet e borxhit, bonot e thesarit dhe instrumente të tjerë

Investimet e mbajtura deri në maturim dhe ato me vlerë të drejtë në fitim ose humbje përbëhen nga bono thesari dhe obligacione. Emetuesi i këtyre instrumenteve është Qeveria Shqiptare. Shërbimi i vlerësimit të Standard & Poor's ka vendosur renditjen 'BB/B' për monedhë të huaj dhe 'BB+/B' në monedhë vendase për këto instrumente të Shqipërisë. Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 këto investime nuk ishin në vonesë dhe nuk ishin të zhvlerësuar.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.1 Risku i kredisë (vazhdim)

3.1.10 Përqëndrimi i riskut në aktivet financiare të ekspozuara në risk krediti

(a) Sektorët gjeografik

Kreditë dhe paradhëniet për bankat janë vendosur me banka të vendeve anëtare të OECD. Të gjithë aktivet e tjera financiare janë vendosur në Shqipëri me përjashtim të aksioneve të VISA të cilat janë të VISA Corporation.

(b) Sektorët e industrisë

Analiza e ekspozimit kryesor të bankës në kredi dhe paradhënie për klientët sipas industrisë paraqitet në shënimin 15.

3.2 Risku i tregut

Risku i tregut është risku që ndryshimet në çmimet e tregut, si normat e interesit, çmimet e kapitalit, kurset e këmbimit dhe normat e kredisë (që nuk lidhen me ndryshimet në gjendjen kreditore të detyruesit/emetuesit) do të ndikojnë të ardhurat e bankës ose vlerën e pjesëmarrjeve të saj në instrumentet financiare. Objektivi i menaxhimit të riskut të tregut është menaxhimi dhe kontrolli i ekspozimeve të riskut brenda parametrave të pranueshëm, duke optimizuar kthimin e riskut.

Çështjet e riskut të tregut ndiqen vazhdimisht dhe rregullisht nga “Komiteti i Menaxhimit të Aktiveve dhe Detyrimeve” (ALCO).

3.2.1 Risku i kursit të këmbimit

Banka ekspozohet kundrejt riskut të monedhës përmes transaksioneve në monedhë të huaj. Banka sigurohet që ekspozimi neto të ruhet në një nivel të pranueshëm duke blerë dhe shitur monedhë të huaj me kursin aktual kur kjo është e nevojshme për të rregulluar çrregullimet e përkohshme.

Menaxhimi vendos limite ndaj nivelit të ekspozimit sipas monedhës, të cilat monitorohen çdo ditë.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.2 Risku i tregut (vazhdim)

3.2.1 Risku i kursit të këmbimit (vazhdim)

Përqëndrimet e riskut të kursit të këmbimit – instrumentet financiare në dhe jashtë bilancit:

	EUR	USD	Të tjera	LEK	Totali
Më 31 dhjetor 2013					
Aktive					
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	10,072,483	920,394	164,488	4,655,195	15,812,560
Kredi dhe paradhënie për bankat	20,131,774	2,139,076	600,091	-	22,870,941
Kredi dhe paradhënie për klientët	21,905,505	1,143,267	25,608	15,626,119	38,700,499
Aktive financiare të disponueshme për shitje	-	110,426	-	16,463,002	16,573,428
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	2,832,216	-	-	1,383,487	4,215,704
Totali i aktiveve financiare	54,941,978	4,313,163	790,187	38,127,703	98,173,032
Detyrime					
Detyrime për bankat	2,202,433	115	28,767	1,004,471	3,235,785
Detyrime për klientët	32,389,924	4,261,344	698,164	41,298,595	78,648,027
Totali i detyrimeve financiare	34,592,357	4,261,459	726,931	42,303,066	81,883,812
Pozicioni në monedhë neto në bilanc	20,349,621	51,704	63,256	(4,175,363)	16,289,220
Zërat jashtë bilancit	794,836	1,219,233	-	805,057	2,819,126
Ndjeshmëria nëse kurset e këmbimit rriten 5%	2,043	246	382	-	2,671
Ndjeshmëria nëse kurset e këmbimit zvogëlohen 5%	(2,043)	(246)	(382)	-	(2,671)

Banka menaxhon ekspozimin e saj në monedhë të huaj duke marrë parasysh që kapitali i saj së bashku me primin janë të emërtuar në Euro.

Ndjeshmëria e paraqitur në tabelën e mësipërme llogarit rritjet / uljet e fitimit para tatimit nëse në datën e raportimit, kursi i këmbimit të Lekut ngrihet / ulet me 5% në lidhje me monedhën e huaj respektive, duke i mbajtur të gjitha variablat e tjera konstante.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.2 Risku i tregut (vazhdim)

3.2.1 Risku i kursit të këmbimit (vazhdim)

Më 31 dhjetor 2012	EUR	USD	Të tjera	LEK	Totali
Aktive					
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	9,035,939	578,583	69,174	4,182,577	13,866,273
Kredi dhe paradhënie për bankat	10,653,521	2,118,736	398,924	-	13,171,181
Kredi dhe paradhënie për klientët	32,208,990	1,509,998	28,063	16,912,268	50,659,319
Aktive financiare të disponueshme për shitje	-	78,555	-	12,132,846	12,211,401
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	2,817,081	-	-	1,901,604	4,718,685
Aktive të tjera financiare	92,734	24,854	-	69,156	186,744
Totali i aktiveve financiare	54,715,531	4,285,872	496,161	35,129,295	94,626,859
Detyrime					
Detyrime për bankat	3,643,303	10,897	23,131	3,836,557	7,513,888
Detyrime për klientët	33,702,174	4,060,787	466,532	34,639,900	72,869,393
Totali i detyrimeve financiare	37,345,477	4,071,684	489,663	38,476,457	80,383,281
Pozicioni në monedhë neto në bilanc	17,370,054	214,188	6,498*	(3,347,162)	14,243,578
Zërat jashtë bilancit	4,117,661	547,898	-	964,252	5,629,811
Ndjeshmëria nëse kurset e këmbimit rriten 5%	264,846	5,355	5,120	-	275,321
Ndjeshmëria nëse kurset e këmbimit zvogëlohen 5%	(264,746)	(5,355)	(5,120)	-	(275,321)

3.2.2 Risku i normës së interesit

Veprimtaria e bankës është subjekt i riskut të ndryshimit të normave të interesit deri në masën që aktivet që fitojnë interes (duke përfshirë investimet) dhe detyrimet që bartin interes maturojnë ose ndryshojnë normat në kohë ose shuma të ndryshme. Në rastin e aktiveve dhe detyrimeve me normë të ndryshueshme, banka ekspozohet edhe ndaj riskut të interesit bazë, e cila është diferenca në karakteristikat e riçmimit të indekseve të ndryshme të përdorura, si norma e kursimit, LIBOR dhe llojet e ndryshme të interesit.

Aktivitetet e menaxhimit të riskut synojnë të optimizojnë të ardhurat neto nga interesi, deri në masën që nivelet në normat e tregut të interesit janë konsistente me strategjinë e biznesit të bankës.

Aktivitetet e menaxhimit të riskut aktiv-detyrim drejtohen në kontekst të ndjeshmërisë së bankës ndaj ndryshimeve në normat e interesit.

Në zvogëlimin e ambienteve të normave të interesit, marzhet e fituara do të zvogëlohen kur normat e interesit për detyrimet do të zvogëlohen me përqindje më të ulët kur krahasohen me normat e interesit për aktivet. Megjithatë, ndikimi real do të varet nga faktorë të ndryshëm, duke përfshirë ekonominë, ambientin dhe nivelin e inflacionit.

Banka mundohet të zvogëlojë riskun e normës së interesit duke monitoruar datat e riçmimit të aktiveve dhe detyrimeve të veta. Për më tepër, banka ka të drejta kontraktuale për të rishikuar çdo tre muaj normat e interesit në pjesën më të madhe të portofolit të kredisë.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.2 Risku i tregut (vazhdim)

3.2.2 Risku i normës së interesit (vazhdim)

Tabela në vijim paraqet datat e riçimitit të normave të interesit për aktivet dhe detyrimet e bankës. Aktivet dhe detyrimet me norma të ndryshueshme janë raportuar në bazë të datës së ardhshme të ndryshimit të normës. Aktivet dhe detyrimet me normë fikse janë raportuar në bazë të datave të ripagesave të skeduluara të principalit:

	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Mbi një vit	Nuk bartin interes	Totali
Më 31 dhjetor 2013						
Aktive						
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	14,153,253	-	-	-	1,659,307	15,812,560
Kredi dhe paradhënie për bankat	16,276,106	6,594,835	-	-	-	22,870,941
Kredi dhe paradhënie për klientët	10,671,159	13,141,866	14,190,753	696,621	-	38,700,399
Aktive financiare të disponueshme për shitje	955,645	3,100,357	10,740,657	1,776,768	-	16,573,427
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	417,207	-	-	3,798,497	-	4,215,704
Totali i aktiveve financiare	42,473,370	22,837,058	24,931,410	6,271,886	1,659,307	98,173,031
Detyrime						
Detyrime për bankat	3,235,785	-	-	-	-	3,235,785
Detyrime për klientët	25,279,688	11,075,675	39,940,421	2,334,968	17,275	78,648,027
Totali i detyrimeve financiare	28,515,473	11,075,675	39,940,421	2,334,968	17,275	81,883,812
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	13,901,413	11,761,383	(15,009,011)	3,936,918	1,642,022	16,232,725

Tabela në vijim përfshin periudhën krahasuese:

	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Mbi një vit	Nuk bartin interes	Totali
Më 31 dhjetor 2012						
Aktive						
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	12,309,365	-	-	-	1,556,908	13,866,273
Kredi dhe paradhënie për bankat	13,171,181	-	-	-	-	13,171,181
Kredi dhe paradhënie për klientët	18,141,911	19,088,341	13,368,324	60,743	-	50,659,319
Aktive financiare të disponueshme për shitje	2,459,194	3,083,560	5,639,130	1,029,517	-	12,211,401
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	4,718,685	-	4,718,685
Totali i aktiveve financiare	46,081,651	22,171,901	19,007,454	5,808,945	1,556,908	94,626,859
Detyrime						
Detyrime për bankat	5,261,047	-	2,252,841	-	-	7,513,888
Detyrime për klientët	21,967,270	10,075,579	40,207,848	611,402	7,294	72,869,393
Totali i detyrimeve financiare	27,228,317	10,075,579	42,460,689	611,402	7,294	80,383,281
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	18,853,334	12,096,322	(23,453,235)	5,197,543	1,549,614	14,243,578

Për shkak të veçorive të tregut Shqiptar, një shumë e madhe e depozitave të klientëve kanë maturitet më të vogël se një muaj. Megjithatë, ndikimi i mundshëm i zhvillimit



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.2 Risku i tregut (vazhdim)

3.2.2 Risku i normës së interesit (vazhdim)

negativ në normat e interesit reduktohet ndjeshëm në sajë të normave të ulta të interesit të vendosura nga banka në depozitat në të parë të klientëve.

Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit është përcaktuar duke u bazuar në ekspozimin e normës së interesit në datën e raportimit. Më 31 dhjetor 2013, nëse normat e interesit do të ndryshonin me 100 pikë bazë më shumë/më pak duke mbajtur të pandryshuara të gjithë faktorët e tjerë, fitimi i bankës para tatimit për periudhën 12 mujore të mbyllur më 31 dhjetor 2013 do të zvogëlohej/rritej përkatësisht me rreth 4,202 mijë Lekë (201: 37,692 mijë Lekë).

Analiza e ndjeshmërisë së normës së interesit sipas monedhave paraqitet si më poshtë.

	EUR	USD	Të tjera	LEK	Totali
Më 31 dhjetor 2013					
Totali i aktiveve financiare që bartin interes	44,869,495	3,392,769	625,699	33,416,024	82,303,987
Totali i detyrimeve financiare që bartin interes	34,592,357	4,261,459	726,931	42,303,026	81,883,773
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	10,277,138	(868,690)	(101,232)	(8,887,002)	420,214
Ndjeshmëria kur normat e interesit rriten 100 pb	102,771	(8,687)	(1,012)	(88,870)	4,202
Ndjeshmëria kur normat e interesit zvogëlohen 100 pb	(102,771)	8,687	1,012	88,870	(4,202)

	EUR	USD	Të tjera	LEK	Totali
Më 31 dhjetor 2012					
Totali i aktiveve financiare që bartin interes	45,679,592	3,704,289	426,987	34,341,645	84,152,513
Totali i detyrimeve financiare që bartin interes	37,345,477	4,071,684	489,663	38,476,457	80,383,281
Hendeku i ndjeshmërisë së interesit	8,334,115	(367,395)	(62,676)	(4,134,812)	3,769,232
Ndjeshmëria kur normat e interesit rriten 100 pb	83,341	(3,674)	(627)	(41,348)	37,692
Ndjeshmëria kur normat e interesit zvogëlohen 100 pb	(83,341)	3,674	627	41,348	(37,692)

3.7 Risku i likuiditetit

Risku i likuiditetit është risku që banka nuk është në gjendje të përmbushë detyrimet e saj për pagesa që lidhen me detyrimet e saj financiare kur ato mbushin afatin e tyre dhe që banka nuk është në gjendje të zëvendësojë fondet e tërhequra me fonde të reja. Pasoja mund të jetë dështim për të përmbushur detyrimet për të ripaguar depozituesit dhe për të përmbushur angazhimet e kredisë.

Banka zbaton një politikë të menaxhimit të riskut të likuiditetit që prej vitit 2003. Kjo politikë rregullohet për të zbatuar praktikat ndërkombëtare dhe ambientet rregullatore dhe përshtatet me aktivitetet specifike të Piraeus Bank.

Politika përcakton përkufizimet kryesore të vlerësimit dhe metodave të përcaktimit të riskut të likuiditetit, përcakton rolet dhe përgjegjësitë e njësive dhe stafit të përfshirë dhe përcakton udhëzimet për menaxhimin e krizave të likuiditetit. Politika është e fokusuar



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.3 Risku i likuiditetit (vazhdim)

në nevojat e pritshme për likuiditet të cilat mund të shfaqen në bazë javore apo mujore, bazuar në skenarët hipotetikë të krizave të likuiditetit.

Për më tepër, politika përcakton një plan rezervë që do të përdoret në rastin e një krize likuiditeti. Një krizë e tillë mund të ndodhë për shkak të një ngjarjeje të veçantë të Tirana Bank ose një ngjarjeje gjithpërfshirëse të tregut. Nxitësit dhe sinjalet paralajmëruese shërbejnë si tregues se kur plani duhet të vihet në veprim. Ky plan emergjence është kryesisht i bazuar në financimin shtesë që do të marrë nga mëma sipas kërkesës.

Tirana Bank llogarit dhe monitoron Raportet e likuiditetit , “aktivet likuide / totali i detyrimeve” dhe “aktivet neto afatshkurtra/totali i detyrimeve”, pasi ato janë përcaktuar në udhëzimet e Bankës së Shqipërisë, të cilat i referohen kuadrit kontrollues të mjaftueshmërisë së likuiditetit të bankave, nga Banka e Shqipërisë (shënimi 2.1.c).

Nivelet e këtyre raporteve të veçanta komunikohen në baza ditore në njësitë përgjegjëse të biznesit, dhe komentet, si dhe vlerësimet përkatëse, janë të përfshira në paketën e raportimit për anëtarët e ALCO.

ALCO ka përgjegjësi: për të hartuar strategjinë e bankës në zhvillimin e aktiveve dhe detyrimeve, në varësi të të dhënave cilësore dhe sasore të organizimit dhe zhvillimit të mjedisit të biznesit, për të siguruar konkurrencën dhe efektivitet të lartë të organizatës, ruajtjen e rrezikut të supozuar brenda kufijve të vendosur, për të menaxhuar aktivet dhe detyrimet duke aplikuar në të njëjtën kohë një politikë të çmimeve të produkteve dhe shërbimeve.

3.7.1 Proçesi i menaxhimit të riskut

Tirana Bank njeh faktin që, në mënyrë që të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet menjëherë dhe pa humbje, është thelbësore që të menaxhohet efektivisht risku i likuiditetit. Risku i likuiditetit është risku që një institucion financiar nuk do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet në momentin kur ato maturohen, për shkak të mungesës së likuiditetit të kërkuar.

Në përgjithësi, menaxhimi i likuiditetit është çështje e balancimit të flukseve të parasë në grupime kohore rritëse, në mënyrë që në kushte normale, banka të vendoset në një pozicion që mund të përmbushë të gjitha detyrimet e saj të pagesave sipas afateve të tyre.

Analiza e hendekut të likuiditetit ofron një pasqyrë të flukseve të pritshme të parasë, të cilat rrjedhin nga të gjitha aktivet e bilancit. Flukset e mjeteve monetare janë grumbulluar dhe përcaktuar në bazë të kohës kur ato ndodhin.

Tabela e mëposhtme analizon aktivet dhe detyrimet në periudhat kohore përkatëse bazuar në periudhën e mbetur në datën e raportimit deri në datën kontraktuale të maturimit. Aktivitet dhe detyrimet në valutë të huaj janë konvertuar në lekë, duke përdorur normat e kursit të këmbimit të fundit të vitit.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.3 Risku i likuiditetit (vazhdim)


3.3.1 Proçesi i menaxhimit të riskut (vazhdim)

Tabela e mëposhtme përmban shifrat të periudhës krahasuese:

Më 31 dhjetor 2012	Më pak se një muaj	Nga 1 në 3 muaj	Nga 3 në 12 muaj	Nga 1 në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Aktive Likuide						
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	13,866,273	-	-	-	-	13,866,273
Kredi dhe paradhënie për bankat	13,171,181	-	-	-	-	13,171,181
Kredi dhe paradhënie për klientët	12,080,930	4,216,742	6,673,714	13,325,479	14,362,453	50,659,319
Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje	-	-	-	-	-	-
Aktive financiare të disponueshme për shitje	2,459,194	3,083,560	5,639,130	1,029,517	-	12,211,401
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	-	4,718,685	-	4,718,685
Totali i aktiveve financiare	41,577,578	7,300,302	12,312,844	19,073,681	14,362,453	94,626,859
Detyrime						
Detyrime për bankat	5,261,047	-	2,252,841	-	-	7,513,888
Detyrime për klientët	21,967,270	10,075,579	40,207,848	611,402	7,294	72,869,393
Detyrime të tjera financiare	387,443	-	-	-	-	387,443
Totali i detyrimeve financiare	27,228,317	10,075,579	42,460,689	611,402	7,294	80,383,281
Hendeku neto i likuiditetit	14,349,261	(2,775,277)	(30,147,845)	18,462,279	14,355,159	14,243,578

Tabela e mëposhtme paraqet flukset e parasë të pagueshme nga banka si detyrime financiare joderivative sipas maturitetit të mbetur kontraktual në datën e raportimit. Shumat e paraqitura në tabelë janë flukse kontraktuale të paskontuara të parasë, ndërsa banka menaxhon riskun e pashmangshëm të likuiditetit bazuar në flukset e pritshme monetare të skontuara.

Më 31 dhjetor 2013	Më pak se një muaj	Nga 1 në 3 muaj	Nga 3 në 12 muaj	Nga 1 në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Detyrime për bankat	3,239,170	-	-	-	-	3,239,170
Detyrime për klientët	25,306,556	11,118,834	40,157,699	2,441,694	-	79,024,783
Totali i detyrimeve financiare	28,545,726	11,118,834	40,157,699	2,441,694	-	82,263,953
Më 31 dhjetor 2012	Më pak se një muaj	Nga 1 në 3 muaj	Nga 3 në 12 muaj	Nga 1 në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Detyrime për bankat	5,267,193	-	-	2,442,721	-	7,709,914
Detyrime për klientët	21,996,639	10,203,207	40,820,241	672,422	7,294	73,699,803
Totali i detyrimeve financiare	27,263,832	10,203,207	40,820,241	3,115,143	7,294	81,409,717



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.3 Risku i likuiditetit (vazhdim)


3.7.2 Zërat jashtë bilancit

Më 31 dhjetor 2013	Më pak se një muaj	Nga 1 në 3 muaj	Nga 3 në 12 muaj	Nga 1 në 5 vite	Mbi 5 vite	Totali
Angazhime kredie	1,146,037	104,865	523,932	17,499	80,616	1,872,949
Letër garanci	50,854	194,197	663,306	-	-	908,357
Letër kredie	-	-	37,820	-	-	37,820
	1,196,891	299,062	1,225,058	17,499	80,616	2,819,126
Angazhime të qirasë operative	-	-	191,026	584,193	138,780	913,999
Totali	1,196,891	299,062	1,416,084	601,692	219,396	3,733,123
Më 31 dhjetor 2012						
Angazhime kredie	3,374,985	195,306	732,998	14,768	69,197	4,387,255
Letër garanci	42,683	190,242	970,616	-	-	1,203,542
Letër kredie	-	-	39,014	-	-	39,014
	3,417,668	385,548	1,742,628	14,768	69,197	5,629,811
Angazhime të qirasë operative	-	-	203,035	710,992	200,319	1,114,346
Totali	3,417,668	385,548	1,945,663	725,760	269,516	6,744,157

Letër kreditë dhe letër garancitë e dhëna për klientët angazhojnë bankën të kryejë pagesa në favor të tyre të cilat janë të kushtëzuara në sajë të dështimit të klientit të veprorë sipas kushteve të kontratës.

Angazhimet për të zgjatur kreditë përfaqësojnë detyrimet kontraktuale për të bërë kredi të ripërtëritshme. Angazhimet në përgjithësi kanë datat e skadimit të përcaktuara, ose dispozita të tjera të përfundimit.

Rrjeti i degëve të Tirana Bank përfshin 45 (2012: 45) ndërtesa të marra me qira me marrëveshje të qirasë operative. Politika e bankës është të lidhë kontrata afatgjata nga 10 deri 20 vjet. Kontratat rinovohen sipas negociimeve midis dy palëve që duhet të bien dakord me kushtet e reja të kontratës.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.8 Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare

Instrumentet financiare që nuk maten me vlerën e drejtë

Tabela e mëposhtme përmbledh vlerat kontabël dhe vlerat e drejta të atyre aktiveve dhe detyrimeve financiare që nuk janë paraqitur në pasqyrat financiare të bankës me vlerën e tyre të drejtë.

	Vlera e mbartur		Vlera e drejtë	
	2013	2012	2013	2012
Aktive financiare				
Kredi dhe paradhënie për bankat	22,870,941	13,171,181	22,870,941	13,171,181
Kredi dhe paradhënie për klientët	38,700,399	50,659,319	35,730,696	43,977,752
Biznes	27,783,926	39,312,877	26,552,313	36,318,388
Konsumatore	2,840,386	2,795,620	2,422,289	2,087,591
Hipotekë	8,019,603	8,550,822	6,756,094	5,571,773
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	4,215,704	4,718,685	4,215,704	4,718,685
Detyrime financiare				
Detyrime për klientët	78,648,027	72,869,393	67,165,160	60,748,023
Detyrime për bankat	3,235,785	7,513,888	3,235,785	7,513,888

a) *Kreditë dhe paradhëniet për bankat*

Kredi dhe paradhënie për bankat përfshijnë vendosje ndërbankare. Vlera e drejtë e vendosjeve me normë të pandryshueshme dhe depozitat njëditore është e barabartë me vlerën e tyre kontabël. Llogaritja e vlerës së drejtë e depozitave me norma të pandryshueshme interesi bazohet në flukset monetare të skontuara duke përdorur normat e interesit që mbizotërojnë në treg për borxhet me risk kreditimi dhe maturitet të mbetur të ngjashëm. Në lidhje me depozitat në institucionet e kredisë, këto janë depozita afatshkurtra, për të cilat interesi që bartin nuk ndryshon shumë nga normat e interesit të tregut më 31 dhjetor.

b) *Kreditë dhe paradhëniet për klientët*

Kreditë dhe paradhëniet nuk përfshijnë zhvlerësimin. Portofoli i kredisë i bankës ka një vlerë të drejtë të llogaritur më të vogël se vlera kontabël për shkak të normave të interesit më të larta mbizotëruese në treg në fund të 2012, si rezultat i krizës globale financiare. Pjesa më e madhe e portofolit të kredive është subjekt çmimi-brenda një viti. Vlera e drejtë e kredive dhe paradhënieve për klientët është fluksi i pritur i skontuar me normat aktuale të tregut. Normat aktuale të tregut janë normat e interesit që do të aplikoheshin në këtë moment (në fund të vitit).

c) *Aktivet financiare të mbajtura deri në maturim*

Vlera e drejtë e investimeve financiare të mbajtura deri në maturim përcaktohet duke përdorur çmimet e kuotuar për instrumente të ngjashme si norma të skontimit të flukseve të ardhshme të parasë në datën e raportimit. Investime të tilla janë afatshkurtra, dhe përsëri norma e interesit nuk ndryshon dukshëm nga norma e interesit të tregut më 31 dhjetor 2012.



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.4 Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

d) Detyrime për bankat dhe klientët, depozita të tjera dhe huamarrje të tjera

Vlera e drejtë e përllogaritur e depozitave me maturitet të pa deklaruar, e cila përfshin depozitat pa interes, është shuma e pagueshme kur kërkohet.

Vlera e drejtë e përllogaritur e depozitave me norma interesi të pandryshueshme dhe huamarrje të tjera të pakuotuar në një treg aktiv bazohet në flukset e skontuara të parasë duke përdorur norma interesi për borxh të ri me maturitet të mbetur të ngjashëm. Vlera kontabël ndryshon nga vlera e drejtë sepse normat e interesit janë më të larta se normat e tregut më 31 dhjetor 2011, sepse në fund të vitit bankat ofrojnë norma më të larta interesi duke konkurruar për të tërhequr depozitat.

Detyrimet për bankat i referohet kredive të marra nga mëma me një afat maturimi prej një muaj nga data e bilancit dhe për këtë arsye vlera e tyre e drejtë konsiderohet të jetë e përafërt me vlerën kontabël.

Instrumente financiare të matura me vlerën e drejtë

Hierarkia e vlerës së drejtë

Dy hierarkitë e mëposhtme janë përdorur nga banka në përcaktimin e vlerave të drejta të aktiveve të saj financiare të mbajtura me vlerën e drejtë nëpërmjet fitimit ose humbjes dhe të instrumenteve të disponueshme për shitje më 31 dhjetor 2012 dhe 2011:

- **Niveli 1**

Çmimet e kuotuar (të parregulluara) në tregjet aktive për aktivet ose detyrimet identike janë përdorur për të përcaktuar vlerën e drejtë të aktiveve financiare. Ky nivel përfshin letra me vlerë në tregjet e këmbimitë

- **Niveli 2**

Të dhëna të tjera përveç çmimeve të kuotuar të përfshira në nivelin 1 që janë të verifikueshme për aktivin ose detyrimin, drejtpërdrejtë (çmimi) ose tërthorazi (e përfutur nga çmimi); dhe

- **Niveli 3**

Të dhëna të tjera jo të observueshme nga të dhënat e tregut.

Menaxhimi përdor gjykime në kategorizimin e strumenteve financiare duke përdorur hierarkinë e vlerës së drejtë. Nëse metoda e matjes përdo të dhëna që kërkojnë gjykime të rëndësishme, ajo metodë është e nivelit 3. Rëndësia e një të dhëne shikohet në tërësi për matjen e vlerës së drejtë. Matjet e përsëritura të vlerës së drejtë janë ato që lejohen ose kërkohen nga standartet e kontabilitetit në pasqyrën e pozicionit financiar në fund të çdo periudhe raportuese. Vlerat e drejta të analizara sipas nivelit të hierarkisë dhe vlerat e përsërituar të aktiveve jo të vlerësuar me vlerën e tyre të drejte paraqiten në tabelën që vijon:



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.4 Vlera e drejtë e aktiveve dhe detyrimeve financiare (vazhdim)

	31 dhjetor 2013			
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Aktive financiare				
Kredi dhe paradhënie për bankat	-	-	22,870,941	22,870,941
Kredi dhe paradhënie për klientët	-	-	38,700,399	38,700,399
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	-	4,215,704	-	4,215,704
Aktive financiare të disponueshme për shitje	-	16,573,427	-	16,573,427
Detyrime financiare				
Detyrime për bankat	-	-	78,648,027	78,648,027
Detyrime për klientët	-	-	3,235,785	3,235,785

	31 dhjetor 2012			
	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Aktive financiare				
Kredi dhe paradhënie për bankat	-	-	13,171,181	13,171,181
Kredi dhe paradhënie për klientët	-	-	50,659,319	50,659,319
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	-	4,718,685	-	4,718,685
Aktive financiare të disponueshme për shitje	-	12,211,401	-	12,211,401
Detyrime financiare				
Detyrime për bankat	-	-	72,869,393	72,869,393
Detyrime për klientët	-	-	7,513,888	7,513,888

3.5 Menaxhimi i kapitalit

Objektivat e Bankës për menaxhimin e kapitalit, i cila është një koncept më i gjerë sesa “kapitali” në bilanc, janë:

- Të jetë në përputhje me kërkesat e kapitalit të vendosura nga Banka e Shqipërisë;
- Të ruaj aftësinë e bankës për të vazhduar në vijimësi në mënyrë që të mund të vazhdojë të sigurojë kthim për aksionerët dhe përfitime për grupet e tjera të interesit, dhe
- Të ruaj një bazë të kapitalit të fortë për të mbështetur zhvillimin e biznesit të saj.

Mjaftueshmëria e kapitalit dhe përdorimi i kapitalit rregullator janë të monitoruara çdo ditë nga drejtuesit e bankës, duke përdorur teknika të bazuara në udhëzimet e zhvilluara nga Komiteti i Baselit dhe Direktivat e Komunitetit Evropian, ashtu siç janë implementuar nga Banka e Shqipërisë, për qëllime të mbikëqyrjes. Informacioni i kërkuar dërgohet në Bankën e Shqipërisë çdo tre muaj.

Banka e Shqipërisë kërkon që çdo bankë ose grup bankar: (a) të mbajë nivelin minimal të kapitalit rregullator prej 1 miliardë Lekë dhe (b) të mbajë një raport të totalit të kapitalit rregullator përmbi aktivet e ponderuara me risk ('raporti Basel') në ose mbi minimumin e pranuar në nivel ndërkombëtar prej 12% (2012: 12%). Banka e Shqipërisë ka kërkuar specifikisht që Tirana Bank të ketë normën e mjaftueshme të kapitalit minimalisht 15%, amidst pasiguritë e krizës financiare në Greqi dhe afektiv potencial të saj në Shqipëri.

Kapitali rregullator i bankës, ashtu siç menaxhohet nga Departamenti i Riskut të bankës, është i ndarë në dy nivele:



3 Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

3.5 Menaxhimi i kapitalit (vazhdim)

- *Kapitali bazë*: kapitali aksioner (duke i zbritur vlerat kontabël të aksioneve të thesarit), fitimi i mbartur dhe rezervat e krijuara si përpjesëtim i fitimit të mbartur; dhe
- *Kapitali shtesë*: borxhi i varur që kualifikohet si kapital, provigjionet e zhvlerësimeve kolektive dhe fitimet e perealizuara nga vlerësimi i drejtë i instrumenteve të kapitalit dhe borxhit të mbajtura si të disponueshme për shitje.

Aktivitetet e ponderuara me risk maten sipas një hierarkie prej katër ponderimesh risku të klasifikuara sipas natyrës – dhe duke pasqyruar një vlerësim të risqeve përkatës të kredisë, tregut dhe risqeve të tjera – çdo aktiv dhe palë e trete, duke marrë parasysh kolateralët apo garancitë e përshtatshme. Një trajtim i ngjashëm përdoret për ekspozimin jashtë bilanci me disa rregullime për të pasqyruar natyrën e kushtëzuar të humbjeve të mundshme.

Tabela në vijim përmbledh përbërësit e kapitalit rregullator dhe raportet e bankës për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 2012. Gjatë këtyre dy viteve, banka ka qenë në përputhje me të gjitha kërkesat e jashtme në lidhje me kapitalin ndaj të cilave është subjekt.

Zbritjet përfaqësojnë investime mbi 10% në institucione financiare dhe aktive afatgjata jomateriale. Aktivitetet afatgjata jomateriale janë të zbritshme nga kapitali bazë dhe nga kapitali shtesë.

	2013	2012
Kapitali bazë		
Kapital i nënshkruar	16,490,344	12,984,103
Rezerva	1,374,250	1,374,250
Diferenca rivlerësimi kreditore	707,405	649,078
Nëntotali 1	18,571,999	15,007,431
Kapitali shtesë		
Detyrime të varura	-	-
Rezerva rivlerësimi	-	-
Totali i kapitalit bazë dhe atij shtesë	-	-
Elementet përbërëse që zbriten	(10,891,797)	(10,894,081)
Totali i kapitalit rregullator	7,680,202	4,113,350
Zërat e aktivitetit të ponderuara me rrezik:		
Në Bilanc	46,462,135	54,836,681
Jashtë Bilancit	1,135,614	555,463
Total i zërave të aktivitetit të ponderuara me rrezik	47,597,749	55,392,144
Norma e mjaftueshmërisë së kapitalit	16,14 %	7,42%

Raporti i mjaftueshmërisë së kapitalit llogaritet duke u bazuar në informacionin financiar të përgatitur sipas rregullores së Bankës së Shqipërisë, të shpjeguar më sipër.



4 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël

Banka kryen vlerësime dhe supozime që ndikojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar. Vlerësimet dhe gjykimet vlerësohen vazhdimisht dhe bazohen në eksperiencën historike dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë për ngjarje të ardhshme që mendohet se janë të arsyeshme në rrethanat aktuale.

(a) Humbje nga zhvlerësimi i kredive dhe paradhënieve

Banka rishikon portofolin e saj të kredisë për të vlerësuar zhvlerësimin të paktën çdo tre muaj. Në përcaktimin nëse një humbje zhvlerësimi duhet të regjistrohet ose jo në fitim ose humbje, banka kryen gjykime nëse ekzistojnë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka një rënie të matshme në vlerësimin e flukseve të ardhshme të parasë nga një portofol kredish para se rënia të identifikohet me një kredi individuale në po atë portofol. Kjo evidencë mund të përfshijë të dhëna të dukshme që tregojnë se ka pasur një ndryshim të pafavorshëm në gjendjen e pagesave të kredimarrësve në një bankë, ose kushte kombëtare ose lokale ekonomike që lidhen drejtpërdrejtë me dështim të aktiveve në një bankë. Menaxhimi përdor vlerësime të bazuara në eksperiencën historike të humbjeve

4 Vlerësime dhe gjykime të rëndësishme kontabël (Vazhdim)

për aktivet me karakteristika të ngjashme të riskut të kredisë dhe të evidencës objektive të zhvlerësimit në portofol kur projektohen flukset e ardhshme të parasë.

Metodologjia dhe supozimet e përdorura për të vlerësuar si shumë ashtu edhe kohën e flukseve të ardhshme rishikohen rregullisht për të reduktuar çdo diferencë që ekziston midis vlerësimeve të humbjeve dhe eksperiencës faktike të humbjes. Në masën që vlera aktuale neto e flukseve të ardhshme ndryshon me $-/+5\%$, provigjioni i bankës do të përllogaritetj 105,729 mijë Lekë më i lartë ose 102,526 mijë Lekë më i ulët (2012: LEK 273,997 mijë Lekë më i lartë ose 247,902 mijë Lekë më i ulët).

(b) Pozicion tatimor i pasigurt

Pozicionet tatimore të Bankës rivlerësohen në fund të çdo periudhe raportuese. Detyrimi për pozicionin e tatimit përcaktohet nga menaxhimi si më i ngjashmi që mund të jetë në mënyrë që të mos rezultojë në detyrime tatimore të tjera që mund të ngrihen nëse pozicioni do të vihej në dyshim nga organet tatimore. Vlerësimi bazohet në interpretime të ligjeve tatimore që janë në fuqi ose konsiderohen në fuqi në fund të periudhës raportuese, dhe të çdo vendim gjykate të njohur ose rregulloreje. Detyrimet nga gjoba, interesa dhe taksa të tjera përveç atyre mbi të ardhurat njihen në bazë të gjykimeve të menaxhimit mbi shpenzimin e nevojshëm për të mbyllur detyrimin në fund të çdo periudhe raportuese.

(c) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Informacione mbi vlerën e drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare që janë përcaktuar nga gjykime të menaxhimit dhe nuk bazohen në të dhëna të observueshme në treg, paraqiten në notën shpjeguese 3.4



5 Adoptimi i standarteve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet

Standardet e reja dhe interpretimet e mëposhtme u bene efektive për Kompaninë që prej 1 Janar 2013:

SNRF 10 “Pasqyrat financiare të konsoliduara” (të lëshuara në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) zëvendëson të gjithë udhëzimet në kontroll dhe konsolidim të SNK 27 “Pasqyrat financiare të ndara dhe të konsoliduara” dhe KIRFN – 12 “Konsolidimi – entitetet me qëllim të veçantë”. SNRF 10 ndryshon përkufizimin e kontrollit në mënyrë që të njëjtat kritere aplikohen te të gjitha entitetet për të përcaktuar kontrollin. Ky përkufizim mbështetet nga udhëzime më të gjera aplikimi. Standardi nuk pati efekt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

SNRF 11 « Marrëveshje të përbashkëta » (i lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) zëvendëson SNK 31 “Interesat në sipërmarrjet e përbashkëta” dhe KIRFN 13 « Entitete të kontrolluara bashkërisht – Kontribute jo monetare nga sipërmarrësit ». Ndryshimet në përkufizime kanë reduktuar numrin e llojeve të marrëveshjeve të përbashkëta në dy : operacione të përbashkëta dhe sipërmarrje të përbashkëta. Zgjedhja e politikës ekzistuese për konsolidimin proporcional të entiteteve të kontrolluara bashkërisht është eliminuar. Kontabiliteti i kapitalit është i detyruar për pjesëmarrësit në sipërmarrje të përbashkëta. Standardi nuk ka patur impakt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

5 Adoptimi i standarteve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet (vazhdim)

SNRF 12 « Paraqitja e interesave në entitete të tjera » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) aplikohet në entitete që kanë interes në një filial, një sipërmarrje të përbashkët, me pjesëmarrje ose një entitet me strukturë të pakonsoliduar. Kjo zëvendëson kërkesat për paraqitje që më përpara gjendeshin te SNK 28 « Investime në Pjesëmarrje ». SNRF 12 u kërkon entiteteve të paraqesin informacionin që ndihmon lexuesit e pasqyrave financiare të vlerësojnë natyrën, riskun dhe efektet financiare të lidhura me interesat e entitetit në filiale, në entitetet me pjesëmarrje, sipërmarrje të përbashkëta dhe entitete me strukturë të pakonsoliduar. Në mënyrë që të arrihen këto objektiva, standardi i ri kërkon paraqitjen në disa fusha, duke përfshirë dhe gjykimet dhe supozimet e bëra nëse një entitet kontrollon, kontrollon bashkërisht, ose influencon në mënyrë të konsiderueshme interesat e saj në entitete të tjera, shpalosjen e mëtejshme të pjesës së interesave të pakontrolluara në aktivitetet e grupit dhe flukseve të mjeteve monetare, të përmbledhura në informacionin financiar të filialeve me interesa të pakontrolluara materiale, paraqitje të detajuara të interesave në entitete me strukturë të pakonsoliduar. Standardi nuk ka patur impakt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

SNRF 13 « Matje në Vlerën e Drejtë » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) përmirësoi konsistencën dhe reduktoi kompleksitetin duke dhënë një përkufizim të rishikuar të vlerës së drejtë, dhe një burim të matjes së vlerës së drejtë dhe kërkesat e paraqitjes për përdorim në të gjithë SNRF-të. Standardi nuk ka patur impakt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

SNK 27 « Pasqyra të Ndara Financiare » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) u ndryshua dhe objektivi i saj tashmë është të përcaktojë kërkesat kontabël dhe të paraqitjes për investimet në filiale. Udhëzimi në kontroll dhe pasqyra financiare të konsoliduara u zëvendësua nga SNRF 10 « Pasqyra



5 Adoptimi i standarteve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet (vazhdim)

Financiare të Konsoliduara». Standardi i ndryshuar nuk ka patur impakt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

SNK 28 « Investimet në pjesëmarrje dhe sipërmarrje të përbashkëta » (e lëshuar në Maj 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013). Ndryshimi i SNK 28 rezultoi nga projekti i Bordit për sipërmarrjet e përbashkëta. Gjatë diskutimit të projektit, Bordi vendosi të përfshijë kontabilitetin për sipërmarrjet e përbashkëta duke përdorur metodën e kapitalit të SNK 28 sepse kjo metodë aplikohet si për sipërmarrjet e përbashkëta ashtu dhe atyre me pjesëmarrje. Përveç këtij rasti, udhëzimet e tjera mbeten të pandryshuara. Standardi i ndryshuar nuk ka impakt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

SNK 1 i ndryshuar « Prezantimi i Pasqyrave Financiare » (e lëshuar në Qershor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) ndryshoi paraqitjen e artikujve të prezantuar të të ardhura të tjera të përmbledhura. Ndryshimet kërkojnë që entitetet të ndajnë artikujt e prezantuar në të ardhura të tjera të përmbledhura në dy grupe, bazuar në faktin nëse ato do të riklasifikohen apo jo në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të ardhmen. Titulli i sugjeruar i përdorur nga SNK 1 ka ndryshuar në « pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve dhe të ardhurave të tjera të përmbledhura ». Standardi i ndryshuar rezultoi në ndryshimin e prezantimit të pasqyrave financiare, po nuk pati impakt në matjen e transaksioneve apo balanca.

SNK 19 i ndryshuar « Përfitimet e Punonjësve » (e lëshuar në Qershor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013) rezultoi në ndryshime të rëndësishme në njohjen dhe matjen e shpenzimeve për pension dhe për largimin nga puna, si dhe për paraqitjen e të gjitha përfitimeve të punonjësve. Standardi kërkon njohjen e të gjitha ndryshimeve në pasivin (aktivin) neto të përcaktuar të përfitimit, në momentin që ato ndodhin si më poshtë :

- (i) Kosto e shërbimit dhe interesi neto në të ardhura shpenzime dhe
- (ii) Rimatjet e të ardhurave të tjera të përmbledhura

Standardi i ndryshuar nuk ka impakt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

« Paraqitja – Kompensimi i Aktiveve dhe Detyrimeve Financiare » – Ndryshimet e SNRF 7 (e lëshuar në Qershor 2011 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013). Ndryshimet kërkojnë paraqitjen në mënyrë të tilla që i mundëson përdoruesit e pasqyrave financiare të Kompanisë të vlerësojnë efektin ose efektin potencial të netimit të rregullimeve, duke përfshirë të drejtat e netimit. Standardi i ndryshuar nuk ka impakt material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

Përmirësime të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (e lëshuar në Maj 2012 dhe efektive për periudhat vjetore duke filluar nga 1 Janar 2013). Përmirësimet konsistojnë në ndryshimet e pesë standardeve. SNFR 1 ndryshoi në (i) qartësimin se entiteti që përmbledh përgatitjen e Pasqyrave Financiare SNFR mund të ketë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme SNFR 1 ose të gjitha SNFR retrospektivisht pasi nuk kishte ndaluar kurrë së aplikuari ato, dhe (ii) për të shtuar një përjashtim nga zbatimi i SNK 23 "Kostot e huamarrjes", në mënyrë retrospektive nga adoptuesit për herë të parë. SNK 1 është ndryshuar për të qartësuar se shënime shpjeguese nuk janë të nevojshme për të



5 Adoptimi i standarteve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet (vazhdim)


mbështetur bilancin e tretë bilancin e paraqitur në fillim të periudhës së mëparshme kur ai jepet pasi ndikohet materialisht nga një riparaqitje retrospektive, ndryshime në politikat kontabël dhe riklasifikime për qëllime prezantimi, ndërkohë që shënimet shpjeguese do të kërkohen kur një entitet në mënyrë vullnetare vendos të japë pasqyra krahasuese shtese. SNK 16 u ndryshua për të sqaruar që pajisjet për shërbim që janë përdorur për më shumë se një periudhë klasifikohen si aktive fikse, jo si inventar. SNK 32 u ndryshua për të sqaruar se pasojat e caktuara tatimore të shpërndarjeve tek pronarët duhet të kontabilizohen në pasqyrën e të ardhurave si kërkohej gjithmonë nga SNK 12. SNK 34 u ndryshua për të sjellë kërkesat e saj në përputhje me SNRF 8.

SNK 34 tani kërkon dhënien e një sasive të totalit të aktiveve dhe detyrimeve për një segment operative vetëm nëse informacioni përkatës i jepet rregullisht vendimmarrësit operacional dhe ka pasur një ndryshim material në ato masa që nga pasqyrat financiare vjetore të fundit . Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të Kompanisë.

"Ndryshimet e Udhëzimeve të Tranzicionit në SNRF 10, SNRF 11 dhe SNRF 12" (publikuar në qershor të vitit 2012 dhe në fuqi për periudhat vjetore që fillojnë 1 janar 2013). Ndryshimet qartësojnë udhëzimet e tranzitore në SNRF 10 " Pasqyrave të Konsoliduara Financiare ". Njësitë ekonomike që adoptojnë SNRF 10 duhet të vlerësojnë kontrollin në ditën e parë të periudhës vjetore në të cilën SNRF 10 është e miratuar , dhe në qoftë se konkluzioni i konsolidimit nën SNRF 10 ndryshon nga SNK 27 dhe KIRFN 12, periudha krahasuese e mëparshme (pra , viti 2012) është riparaqitur , përveç nëse e pazbatueshme. Ndryshimet gjithashtu të sigurojnë lehtësim tranzicioni shtesë në SNRF 10 , SNRF 11 " Marrëveshjet e përbashkëta " dhe SNRF 12 "Shpalosja e interesave në entitete të tjera " , duke kufizuar kërkesën për të siguruar informacion të përshtatur krahasues vetëm për periudhën që menjëherë paraprin periudhën krahasuese . Më tej , ndryshimet heqin kërkesën për të paraqitur informacion krahasues për dhënien e informacioneve shpjeguese në lidhje me subjektet e pakonsoliduara të strukturuar për periudha para se SNRF 12 të zbatohet për herë të parë . Standardi i ndryshuar nuk ka pasur ndonjë ndikim material në pasqyrat financiare të kompanisë, përveç zbatimit të lehtësim nga zbulimi i disa informacioneve krahasuese në shënimet shpjeguese të pasqyrave financiare.

Standarde dhe interpretime të tjera të rishikuara: KIRFN (Komiteti i Interpretimit të Raportimit Financiar Ndërkombëtar) 20 "Kostot e pastrimit të minierave sipërfaqësore në fazën e prodhimit", merr në konsideratë kur dhe si të llogariten përfitimet që rrjedhin nga aktiviteti i pastrimit të sipërfaqes në industrinë e minierave. Interpretimi nuk kishte ndonjë ndikim në pasqyrat financiare të Kompanisë.

Ndryshimet në SNRF 1 "Adoptimi i Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për herë të parë – Kreditë qeveritare", të cilat janë lëshuar në Mars 2012 dhe të bëra efektive për periudha njëvjeçare duke filluar nga 1 Janar 2013, ju vijjnë në ndihmë përdoruesve për herë të parë të SNRF-ve nga zbatimi i plotë retrospektiv i kërkesave të kontabilitetit për kreditë e marra nga qeveria me norma më të ulëta se tregu. Ndryshimi nuk është i vlefshëm për Kompaninë.



5 Adoptimi i standarteve të reja ose të rishikuara dhe interpretimet (vazhdim) Deklarime të reja kontabël

Janë hartuar disa standarde dhe interpretime të reja që janë të detyrueshme për periudha një-vjeçare duke filluar nga 1 Janar 2014 ose më vonë, dhe të cilat nuk janë përdorur nga Kompania më përpara.

SNRF 9 "Instrumentet Financiare: Klasifikimi dhe vlerësimi". Veçoritë kryesore të standardit të hartuar në Nëntor 2009 dhe të ndryshuar në Tetor 2010, Dhjetor 2011 dhe Nëntor 2013 janë:

- Instrumentet financiare kërkohet të klasifikohen në dy kategori: ato që vlerësohen me vlerën e drejtë dhe ato që maten me koston e amortizuar. Vendimi për këtë merret në fazën fillestare të njohjes së instrumentit financiar. Klasifikimi varet nga modeli i biznesit të njësisë për të menaxhuar këto instrumente dhe karakteristikat e flukseve të mjeteve monetare të kontraktuara të instrumentit.
- Një instrument mbahet me kosto të amortizuar vetëm nëse është instrument borxhi, si dhe (i) objektivi i modelit të biznesit të njësisë është ta mbajë aktivin deri në mbledhjen e flukseve të mjeteve monetare të kontraktuara dhe (ii) flukset e mjeteve monetare të kontraktuara të aktivit përfaqësojnë vetëm pagesat e principalit dhe interesit (që do të thotë se aktivi ka vetëm "karakteristika bazë të kredisë"). Të gjitha instrumentet e tjera të borxhit mbahen me vlerën e drejtë duke krijuar fitim ose humbje.
- Të gjithë instrumentet e kapitalit mbahen me vlerë të drejtë. Instrumentet e kapitalit të mbajtura për shitje do të mbahen me vlerë të drejtë me fitim apo humbje. Për të gjithë investimet e tjera në instrumente kapitali, në fazën e njohjes fillestare bëhet një zgjedhje e pandryshuar për të njohur fitimet apo humbjet e realizuara ose të porealizuara në të ardhurat e tjera përmbledhëse në vend të fitimit ose humbjes. Nuk duhet bërë riciklim i fitimeve nga vlera e drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Kjo zgjedhje mund të bëhet në bazë të instrumentit. Dividendët paraqiten në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për sa kohë që ata përfaqësojnë një kthim nga investimi.
- Shumë nga kërkesat e SNK 39 për klasifikimin dhe vlerësimin e detyrimeve financiare kaluan të pandryshuara në SNRF 9. Ndryshimi i vetëm konsiston në kërkesën që njësia të paraqesë efektet e ndryshimeve në riskun e kredisë të detyrimeve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në të ardhura të tjera përmbledhëse.
- Kërkesat e kontabilitetit të mbrojtjes u ndryshuan me qëllim që ta lidhin kontabilitetin më shumë me menaxhimin e riskut. Standardi ju ofron njësive një mundësi për zgjedhjen e politikës kontabël ndërmjet kërkesave të zbatimit të kontabilitetit të mbrojtjes në SNRF 9 dhe vazhdimin të aplikimit të SNK 39 për të gjitha mbrojtjet sepse standardi aktual nuk trajton kontabilitetin për mbulimet makro.



6 Të ardhura nga interesi dhe të ngjashme

	2013	2012
Të drejtat nga bankat dhe Banka e Shqipërisë	354,643	276,048
Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje	688,887	705,502
Investime financiare të mbajtura deri në maturim	529,591	492,904
Interesi nga kreditë dhe paradhëniet e klientëve	2,779,987	3,958,375
Interesi nga paradhëniet	231,980	194,811
	<u>4,585,088</u>	<u>5,627,640</u>

Komisionet e kredisë të njohura në fitim ose humbje llogariten duke përdorur metodën e interesit efektiv. Të ardhurat nga interesi i maturuar i kredive të zhvlerësuar gjatë vitit 2013 është 48.126 mijë Lekë (2012: 26,738 mijë Lekë).

7 Shpenzime interesi dhe të ngjashme

	2013	2012
Detyrime për bankat	117,536	261,709
Detyrime për klientët	2,822,867	2,507,446
	<u>2,940,403</u>	<u>2,769,155</u>

8 Të ardhura nga tarifat dhe komisionet, neto

	2013	2012
Transaksione në monedhë të huaj	3,328	3,579
Letër kredi	23,039	26,996
Transferta parash	74,537	73,057
Importe-eksporte	33,376	22,835
Tarifa të tjera të arkëtuara	114,891	120,778
Të ardhura totale nga tarifa dhe komisione	<u>249,171</u>	<u>247,245</u>
Karta krediti	(24,883)	(8,185)
Banka korrespondente	(12,047)	(11,799)
	<u>(36,930)</u>	<u>(19,984)</u>
Të ardhura neto për tarifa dhe komisione	<u>212,241</u>	<u>227,261</u>

9 Fitime të tjera

	2013	2012
Fitim minus humbje nga transaksionet në monedhë të huaj	337,856	239,959
Fitime/(humbje) nga vlera e drejtë e aktiveve financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje	(101,822)	(38,201)
	<u>236,034</u>	<u>201,758</u>



10 Të ardhura të tjera operative

	2013	2012
Të ardhura nga qiraja	2,749	1,120
Të ardhura të tjera operative	49,580	-
	<u>52,329</u>	<u>1,120</u>

Banka ka lidhur marrëveshje qiraje si qiradhënës për ndërtesa në pronësi. Për këto ekzistojnë kontrata vjetore të rinovueshme midis palëve. Nuk ka qira të kushtëzuar në lidhje me këto marrëveshje qiraje operative. Pagesat minimale të paanullueshme të qirasë janë si më poshtë.

	2013	2012
Jo më shumë se një vit	2,749	1,120
Më shumë se një vit por jo më shumë se pesë vjet	-	-
Më shumë se pesë vjet	-	-

11 Shpenzime për personelin

	2013	2012
Paga	496,793	441,158
Kontribut për fondin shtetëror të pensioneve	56,980	56,497
Kosto të sigurimeve shoqërore	6,458	6,403
Shpenzime të tjera për personelin	19,768	11,141
	<u>579,999</u>	<u>515,199</u>

12 Shpenzime të tjera operative

	2013	2012
Shpenzime të qirasë operative	219,939	224,806
Tarifa për sigurimin e depozitave (ASD)	210,234	194,688
Shpenzime telekomunikacioni	104,387	115,606
Reklama dhe marketing	53,261	50,146
Shpenzime për siguri dhe mirëmbajtje	109,449	107,257
Anëtarësime	78,864	74,918
Shpenzime për shërbime bazë	51,242	53,938
Kancelari dhe të konsumueshme	31,409	39,687
Shpenzime udhëtimi	15,017	14,023
Shpenzime të tjera sigurimi	23,681	15,866
Tarifa dhe shpenzime të ngjashme	8,565	8,400
Të tjera	82,697	87,202
	988,745	986,537



Gjatë aktivitetit të saj operativ, banka hyn në marrëdhënie të qirasë operative si qiramarrës për ambientet që përdor për degët. Marrëveshjet e qirasë operative janë në Euro dhe USD. Pagesat minimale të qirasë sipas marrëveshjeve të paanullueshme të qirasë operative paraqiten në shënimin 3.3.2.

13 Shpenzime të tatim-fitimit

Përbërësit e shpenzimit të tatim-fitimit për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 janë:

	2013	2012
Tatimi aktual		
Tatimi aktual mbi të ardhurat	-	-
Tatimi i shtyrë		
Në lidhje me krijimin dhe rimarrjen e diferencave të përkohshme	31,290	(546)
Shpenzimi i tatim-fitimit i raportuar në fitim ose humbje të vitit	31,290	(546)

Rakordimi midis shpenzimit tatimor dhe fitimit kontabël i shumëzuar me normat vendase në Shqipëri për vitet e mbyllur më 31 dhjetor 2013 dhe 2012 është si vijon:



13 Shpenzime të tatim-fitimit (vazhdim)

	2013	2012
Fitimi kontabël para tatimit	(1,333,772)	(196,984)
Me normën vendase të tatim-fitimit 10%	(133,377)	(19,698)
Efekti tatimor i zërave jo të zbritshëm ose nuk janë të vlerësueshëm për qëllime tatimore	44,944	18,814
-Të ardhura jo të tatueshme	(3,537)	(4,493)
-Shpenzime të pazbritshme	48,481	23,307
-Humbje fiskale e mbartur e panjohur	88,433	884
-Tatim fitimi/(humbja) e shtyrë	31,290	(546)
Shpenzimi i tatim-fitimit i raportuar në fitim ose humbje të vitit	31,290	(546)

Banka ka aktive tatimore të shtyra potenciale të panjohura në respekt me humbjet fiskale të papërdorura të mëparshme prej Lek 89,317 mijë (2012: Lek 884 mijë). Humbjet fiskale të mbartura skadojnë si më poshtë:

	2013	2012
Hubje fiskale të mbartura që skadojnë në fund të:		
- 31 dhjetor 2013	-	-
- 31 dhjetor 2014	-	-
- 31 dhjetor 2015	884	884
- 31 dhjetor 2016	88,433	-
- 31 dhjetor 2017	-	-
Totali i humbjes fiskale të mbartur	89,317	884

Norma efektive e tatimit për vitin 2013 nuk ka (2012: nuk ka). Sipas legjislacionit tatimor shqiptar, autoritetet tatimore kanë të drejtë të inspektojnë një deklaram 5 vjet pas dorëzimit të tij.

Të drejta nga tatim fitimi

	2013	2012
1 janar	259,726	148,541
Parapagime gjatë vitit	40,953	111,185
Shpenzimi i tatim fitimit	-	-
31 dhjetor	300,679	259,726

Tatim i shtyrë që përfshihet në bilanc dhe shpenzimet e regjistruara në pasqyrën e të ardhurave janë si në vijim:



13 Shpenzime të tatim-fitimit (vazhdim)

	2013				2012			
	Aktiv tatimor i shtyrë	Detyrim tatimor i shtyrë	Pasqyra e të ardhurave (Dr)/Cr	Aktive financiare të disponueshm e për shitje Rezervë (Dr)/Cr	Aktiv tatimor i shtyrë	Detyrim tatimor i shtyrë	Pasqyra e të ardhurave (Dr)/Cr	Aktive financiare të disponuesh me për shitje Rezervë (Dr)/Cr
Vlerësim fillestar dhe kosto e AAM	-	7,070	-910	-	-	6,160	1,162	-
Vlerë e drejtë në fitim ose humbje	-	-	-	-	-	-	3,407	-
Të disponueshme për shitje	-	40,952	-	29,264	-	11,688	63	(5,675)
Shpenzime të nisjes dhe të kapitalizuara	-	42,954	(8,619)	-	-	34,335	(5,723)	-
Rregullim për amortizim të aktiveve fikse	96,898	-	35,599	-	61,299	-	3,420	-
Komisione të shtyra kredie	21,831	-	5,221	-	16,610	-	(2,875)	-
Provizione kredi të llogaritura sipas rregullave të BSHI dhe SNRF	-	-	-	-	-	-	-	-
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	-	-	-
Totali	118,729	90,976	31,290	29,264	77,909	52,183	(546)	(5,675)
Detyrime tatimore të shtyra, neto	27,752				25,726			

14 Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore

	2013	2012
Arka		
Kartëmonedha dhe monedha në LEK	761,756	718,236
Kartëmonedha dhe monedha në monedhë të huaj	897,551	838,671
	1,659,307	1,556,907
Gjendje me Bankën Qendrore		
Llogari rrjedhëse		
në LEK	-	232,507
në monedhë të huaj	3,786,282	576
	3,786,282	233,083
Rezervat e detyrueshme		
në LEK	3,893,439	3,214,526
në monedhë të huaj	3,539,384	3,598,966
	7,432,823	6,813,492
Interes i maturuar	14,900	14,300
Totali i gjendjeve me Bankën Qendrore	11,234,005	7,060,875
Paraja në transit me bankat korrespondente	-	362,934

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)

Llogari rrjedhëse me bankat	2,919,248	4,885,557
Interes i maturuar	-	-
Totali i llogarive rrjedhëse me bankat	2,919,248	5,248,491
	15,812,560	13,866,273
Afatshkurtër	15,812,560	13,866,273
Afatgjatë	-	-



Rezervat e detyrueshme me Bankën Qendrore nuk janë për përdorim të përditshëm nga Tirana Bank dhe përfaqësojnë një depozitë rezerve minimale, e cila kërkohet nga Banka e Shqipërisë. Këto rezerva llogariten sa 10% e shumës mesatare të depozitave të muajit për të cilat banka u detyrohet klientëve, dhe janë si në Lekë ashtu edhe në monedhë të huaj (USD dhe EUR).

Mjetet monetare dhe gjendjet me Bankën Qendrore, me përjashtim të arkës, përfshihen në analizën e ekspozimit maksimal nda riskut të kredisë (shënimi 3.1.4).

Normat e interesit për rezervat e detyrueshme gjatë vitit 2013 dhe 2012, u luhatën si në vijim:

2013

Monedha	Minimumi	Maksimumi	Metoda e llogaritjes
LEK	1.75%	2.275%	70% e kthimit të marrëveshjeve të riblerjes
USD	0%	0%	
EUR	0%	0%	

2012

Monedha	Minimumi	Maksimumi	Metoda e llogaritjes
LEK	2.80%	2.80%	70% e kthimit të marrëveshjeve të riblerjes
USD	0%	0%	
EUR	0%	0%	

Llogaritë rrjedhëse me Bankën Qendrore nuk bartin interes. Normat e interesit për llogaritë e tjera rrjedhëse janë të ndryshueshme. Llogaritë rrjedhëse (Nostro dhe në të parë) detajohen në tabelën në vijim.

	<i>S&P</i> <i>AGJ/ASH</i>	<i>2013</i>	<i>2012</i>
Llogari rrjedhëse me bankat			
Deutsche Bank AG	A+/A-	2,468,588	4,761,829
Deutsche Bank Trust Company Americas	A/A-1	352,380	39,389
Piraeus Bank SA	CCC/C	53,313	62,460
National Westminster Bank plc	A+/A-1	17,365	2,953
Raiffeisen Bank International AG	A/A-1	4,395	6,214
Banca Popolare di Vicenza	BBB+/A-2	10,863	9,955
Standard Chartered Bank Frankfurt	A+/A-1	5,041	1,640

Tirana Bank sh.a.

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)



Standard Chartered Bank Neë York	A+/A-1	4,407	
Banco Popolare		2,896	1,117
Totali		2,919,248	4,885,557

15 Kredi dhe paradhënie për bankat

	<i>2013</i>	<i>2012</i>
Vendosje me afat me bankat		
Rezident	-	-
Jorezident	15,847,779	13,121,266
	7,006,931	-
	22,854,710	13,121,266
Interes i maturuar	16,231	49,915
	22,870,941	13,171,181
Afatshkurtër		
Afatgjatë	22,870,941	13,171,181

Normat e interesit për kreditë për bankat janë të pandryshueshme.

Kredi dhe paradhënie për bankat detajohen në tabelën në vijim.

<u>31 dhjetor 2013</u>	<i>S&P</i> <i>AGJ/AF</i>	<i>Monedha</i>	<i>Në monedhë</i> <i>originale</i>	<i>Në LEK '000</i>
Piraeus Bank SA	CCC/C	EUR	56,500,000	7,921,300
Piraeus Bank SA	CCC/C	EUR	49,978,111	7,006,931
Piraeus Bank SA	CCC/C	JPY	176,000,000	170,685
San Paolo di Torino	BBB+/A-2	EUR	10,000,000	1,402,000
Deutsche Bank		USD	10,000,000	1,018,600
Deutsche Bank		GBP	2,550,000	429,394
Societe Generale		EUR	27,000,000	3,785,400
Raiffeisen Austria	A/A-1	USD	11,000,000	1,120,400
Totali				22,854,710

<u>31 dhjetor 2012</u>	<i>S&P</i> <i>AGJ/AF</i>	<i>Monedha</i>	<i>Në monedhë</i> <i>originale</i>	<i>Në LEK '000</i>
Piraeus Bank SA	CCC/C	EUR	56,000,000	7,817,040
Piraeus Bank SA	CCC/C	USD	1,500,000	158,775
Piraeus Bank SA	CCC/C	GBP	2,310,000	395,426
San Paolo di Torino	BBB+/A-2	EUR	20,000,000	2,791,800
Raiffeisen Austria	A/A-1	EUR	18,500,000	1,958,225
Totali				13,121,266



16 Kredi dhe paradhënie për klientët

	2013	2012
Kredi korporatë	1,489,328	1,755,919
Kredi SME	30,435,910	41,602,425
Totali kredive korporatë dhe SME	31,925,238	43,358,344
Kredi konsumatore	2,321,900	2,426,654
Hipotekë	8,513,712	8,842,636
Paradhënie	380,515	300,976
Karta kredie	244,875	215,686
Komisionet e shtyra të kredisë	(221,231)	(256,603)
Interes i maturuar	665,607	977,582
Kredi dhe paradhënie bruto	43,830,616	55,865,275
Minus: Provigjion për humbje zhvlerësimi	(5,130,217)	(5,205,956)
	38,700,399	50,659,319
Afatshkurtër	17,114,443	22,880,603
Afatgjatë	21,585,956	27,778,716

Tabela në vijim tregon analizën e kredive bruto (pa marrë në konsideratë “Komisionet e shtyra të kredisë” dhe “Interesin e maturuar”) për klientët korporatë dhe SME.

	2013	2012
Prodhim	6,570,387	9,698,065
Energji	3,170,767	3,298,492
Tregti	8,499,772	9,858,163
Ndërtim	4,537,848	9,081,368
Industri të tjera	9,146,464	11,422,256
Totali i kredive bruto	31,925,238	43,358,344

Normat e interesit për kreditë dhe paradhëniet ndryshojnë si në vijim:

Monedha	Interesi	Norma shtesë për penalitet
2013		
LEK	12 muaj BLR + (2-10,2)%	3,0%
USD	12 muaj USD + (4-7,0)%	3,0%
EUR	12 muaj EUR+ (3-7,5)%	3,0%
2012		
LEK	12 muaj BLR + (2-10,2)%	3,0%
USD	12 muaj USD + (4-7,0)%	3,0%
EUR	12 muaj EUR + (3-7,5)%	3,0%

Shënime shpjeguese për pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2013

(Të gjitha shumat janë në mijë Lekë përveç rasteve kur përmendet ndryshe)



16 Kredi dhe paradhënie për klientët (vazhdim)

Lëvizja në provigjionin për humbje nga kreditë dhe paradhëniet për klientët është si vijon:

	2013	2012
Më 1 janar	5,205,956	3,665,844
Fshirje	(1,391,054)	-
Shpenzimi i vitit	1,315,316	1,540,112
Më 31 dhjetor	5,130,217	5,205,956
Provigjione individuale	4,075,006	4,168,961
Provigjione kolektive	1,055,211	1,036,995
	5,130,217	5,205,956
Shuma bruto e kredive të përcaktuara për provigjionim individual para zbritjes së provigjioneve të vlerësuara individualisht	29,065,664	23,267,644

Lëvizjet në provigjionin për humbje sipas kategorive të kredive gjatë vitit 2013 është si vijon:

	Korporatë	SME	Konsumatore	Hipotekë	Karta krediti dhe paradhënie	Totali
Më 1 janar 2012	48,639	4,708,229	161,175	287,913	-	5,205,956
Fshirje		(1,391,054)				(1,391,054)
Shpenzimi i vitit	945	1,227,852	(161,175)	193,629	54,064	1,315,316
Më 31 dhjetor 2013	49,584	4,545,027	-	481,542	54,064	5,130,217

Lëvizjet në provigjionin për humbje sipas kategorive të kredive gjatë vitit 2011 është si vijon:

	Korporatë	SME	Konsumatore	Hipotekë	Karta krediti dhe paradhënie	- Totali
Më 1 janar 2012	38,401	2,893,019	241,680	475,180	17,564	3,665,844
Shpenzimi i vitit	10,238	1,815,210	(80,505)	(187,267)	(17,564)	1,540,112
Më 31 dhjetor 2012	48,639	4,708,229	161,175	287,913	-	5,205,956



17 Aktive financiare të disponueshme për shitje

	<i>2013</i>	<i>2012</i>
Visa shares	110,426	78,555
Obligacione qeveritare	1,986,685	1,443,651
Bono thesari qeveritare	14,476,316	10,689,195
	<u>16,573,427</u>	<u>12,211,401</u>

Aksione në Visa Inc	<i>2013</i>	<i>2012</i>
Më 1 janar	78,555	53,457
(Humbje)/fitim nga ndryshimi i vlerës së drejtë	31,871	25,098
Më 31 dhjetor	<u>110,426</u>	<u>78,555</u>

Aksionet në Visa Inc të poseduara nga Banka janë dhuruar nga Visa si një formë shpërblimi për bashkëpunimin afatgjatë me bankën. Aksionet janë dhuruar në bazë të performances mbi të ardhurat dhe objektivat e shpenzimeve të marketingut.

Obligacione qeveritare	<i>2013</i>	<i>2012</i>
Më 1 janar	1,443,651	409,629
Blerje	800,000	1,017,189
Të maturuara	(382,989)	-
Fitimi nga ndryshimi i vlerës së drejtë	126,023	16,833
Më 31 dhjetor	<u>1,986,685</u>	<u>1,443,651</u>

Bono thesari qeveritare	<i>2013</i>	<i>2012</i>
Më 1 janar	10,689,195	5,030,730
Blerje	14,726,679	10,624,035
Të maturuara	(10,958,119)	(4,980,946)
Fitimi nga ndryshimi i vlerës së drejtë	18,561	15,376
Më 31 dhjetor	<u>14,476,316</u>	<u>10,689,195</u>

18 Aktive financiare të mbajtura deri në maturim

	2013	2012
Kosto	4,150,600	4,638,400
Interes i maturuar	70,305	88,276
Zbritje e paamortizuar	(5,201)	(7,991)
	<u>4,215,704</u>	<u>4,718,685</u>
Afatshkurtër	417,207	510,977
Afatgjatë	3,798,497	4,207,708



Shuma prej 4,215,704 mijë Lek më 31 dhjetor 2013 përbëhet nga 1,383,488 mijë Lekë, investime në obligacionet e Qeverisë Shqiptare të emërtuara në Lekë dhe 2,832,216 mijë Lekë janë investime në obligacionet e Qeverisë Shqiptare të emërtuara në Euro.

Instrumente të Qeverisë Shqiptarë në monedhë të huaj vlerësohen si “BB/B” dhe “BB+/B” në monedhë vendase nga “Standard and Poor’s”. Nuk ka shuma të prapambetura më 31 dhjetor 2013.

Normat e interesave për obligacionet e Qeverisë Shqiptare janë të pandryshueshme. Maturitetet e obligacioneve të Qeverisë Shqiptare janë si më poshtë:

31 dhjetor 2013

Maturiteti	Kosto	Interes i maturuar	Zbritje e paamortizuar	Vlera kontabël
Deri 12 muaj	400,000	17,207	-	417,207
12 – 24 muaj	3,750,600	53,098	(5,201)	3,798,497
	<u>4,150,600</u>	<u>70,305</u>	<u>(5,201)</u>	<u>4,215,704</u>

31 dhjetor 2012

Maturiteti	Kosto	Interes i maturuar	Zbritje e paamortizuar	Vlera kontabël
Deri 12 muaj	500,000	10,977	-	510,977
12 – 24 muaj	4,138,400	77,299	(7,991)	4,207,708
	<u>4,638,400</u>	<u>88,276</u>	<u>(7,991)</u>	<u>4,718,685</u>

Lëvizjet në obligacionet e Qeverisë Shqiptare janë si në vijim:



18 Aktive financiare të mbajtura deri në maturim (vazhdim)

Obligacione Qeveritare	2013	2012
Më 1 janar	4,718,685	5,600,728
Blerje gjatë vitit	-	710
Maturime gjatë vitit	(502,981)	(882,753)
Më 31 dhjetor	<u>4,215,704</u>	<u>4,718,685</u>

19 Aktive afatgjata jomateriale

	Programe
Kosto:	
Më 1 janar 2012	862,243
Shtesa	134,710
Më 31 dhjetor 2012	<u>996,953</u>
Më 1 janar 2013	996,953
Shtesa	79,034
Më 31 dhjetor 2013	<u>1,075,987</u>
Amortizimi:	
Më 1 janar 2012	498,790
Amortizimi i vitit	96,341
Më 31 dhjetor 2012	<u>595,131</u>
Më 1 janar 2013	595,131
Amortizimi i vitit	127,166
Më 31 dhjetor 2013	<u>722,297</u>
Vlera kontabël neto	
Më 31 dhjetor 2012	<u>401,822</u>
Më 31 dhjetor 2013	<u>353,690</u>



20 Aktive afatgjata materiale (vazhdim)

	Toka dhe ndërtesa	Automjete	Mobilie dhe pajisje elektronike	Përmirësime të qiramarrjeve	Totali
Kosto:					
Më 1 janar 2012	709,450	154,072	1,512,480	1,086,897	3,462,899
Shtesa	-	6,894	38,787	7,560	53,241
Pakësime	-	(8,529)	(19,906)	-	(28,435)
Më 31 dhjetor 2012	709,450	152,437	1,531,361	1,094,457	3,487,705
Më 1 janar 2013	709,450	152,437	1,531,361	1,094,457	3,487,705
Shtesa	-	535	50,910	3,353	54,798
Pakësime	-	(9,343)	(24,874)	(51,830)	(86,047)
Më 31 dhjetor 2013	709,450	143,629	1,557,397	1,045,980	3,456,456
Amortizimi:					
Më 1 janar 2012	170,281	101,557	1,238,922	648,735	2,159,495
Amortizimi i vitit	33,840	21,489	127,079	89,935	272,343
Dalje	-	(518)	(9,417)	-	(9,935)
Më 31 dhjetor 2012	204,121	122,528	1,356,584	738,670	2,421,903
Më 1 janar 2013	204,121	122,528	1,356,584	738,670	2,421,903
Amortizimi i vitit	33,839	20,156	92,801	102,503	249,299
Dalje	-	(9,343)	(24,335)	(50,761)	(84,439)
Më 31 dhjetor 2013	237,960	133,341	1,425,050	790,412	2,586,763
Vlera kontabël neto					
Më 31 dhjetor 2012	505,329	29,909	174,777	355,787	1,065,802
Më 31 dhjetor 2013	471,490	10,288	132,347	255,568	869,693



21 Aktive të tjera

	2013	2012
Aktive të tjera financiare		
Debitorë të tjerë	244,485	154,169
Të arkëtueshme për kartat Visa	35	852
Llogari të tjera të arkëtueshme nga klientë	59,602	31,723
Totali i aktiveve të tjera financiare	304,122	186,744
Paradhënie	292	905
Inventarë	54,461	62,344
Kolateralë të marrë	1,155,416	754,719
Shpenzime të parapaguara	47,476	60,610
Aktive të tjera	92,709	40,124
Totali i aktiveve të tjera	1,654,476	1,105,446
Afatshkurtër	300,679	259,726
Afatgjatë	1,654,476	1,105,446

Kolateralët e riposeduara përfaqësojnë aktive në pasuri të paluajtshme të blera nga banka në shlyerje të kredive që u ka mbaruar afati. Banka parashikon të shesë aktivin në të ardhmen. Aktivi nuk përmbush definicionin e aktiveve afatgjata të disponueshme për shitje, dhe klasifikohen si inventar në përputhje me SNK 2 "Inventari". Aktivët njihen fillimisht me vlerën e drejtë në momentin e blerjes. Një humbje nga zhvlerësimi në Lek 61,433 mijë u njoh gjatë vitit ushtrimor:

	2013	2012
Më 1 janar	754,719	263,564
Të riposeduar gjatë vitit	462,130	491,155
Hubje nga zhvlerësimet	(61,433)	-
Më 31 dhjetor	1,155,416	754,719

Të gjithë aktivët e mësipërm pritët të merren për më shumë se 12 muaj mbas fundit të vitit, përveç parapagimeve për tatim fitimin pas kontrollit tatimor prej Lek 300,679 mijë (2012: nuk ka).



22 Detyrime për bankat

	2012	2011
Llogari rrjedhëse		
Rezidentë	206,699	6,882
Jorezidentë	4,823	12,294
	<u>211,522</u>	<u>19,176</u>
Hua		
Rezidentë	891,633	3,880,865
Jorezidentë	2,131,603	3,582,838
	<u>3,023,236</u>	<u>7,463,703</u>
Interes i maturuar	<u>1,027</u>	<u>31,009</u>
	<u>3,235,785</u>	<u>7,513,888</u>
Afatshkurtër	3,235,785	7,513,888
Afatgjatë	-	-

Hua nga banka jorezidente lidhen kryesisht me kredi nga Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim dhe Piraeus Bank S.A. Greqi (mëma), për të përmbushur nevojat e bankës për likuiditet. Interesi i maturuar nga huatë me bankat jorezidente për vitin 2013 është 628 mijë Lekë (2012: 19,846 mijë Lekë). Këto detyrime bartin interes të ndryshueshëm.

23 Detyrime për klientët

	2013	2012
Korporate		
Llogari rrjedhëse	4,072,062	3,198,390
Depozita me afat	2,840,170	2,801,223
Depozita të tjera	580,746	722,895
	<u>7,492,978</u>	<u>6,722,508</u>
Individë		
Llogari rrjedhëse/kursimi	8,453,344	7,105,673
Depozita me afat	60,679,500	56,908,769
Depozita të tjera	1,134,151	1,324,849
	<u>70,266,995</u>	<u>65,339,291</u>
Interes i maturuar	<u>870,819</u>	<u>800,300</u>
Çeqe të pagueshme dhe transfertat	<u>17,275</u>	<u>7,294</u>
	<u>78,648,027</u>	<u>72,869,393</u>
Afatshkurtër	76,312,980	72,250,697
Afatgjatë	2,335,007	618,696



23 Detyrime për klientët (vazhdim)

Një shumë prej 665,726 mijë Lekë (2012: 916,802 mijë Lekë) është përfshirë si depozitë e mbajtur si kolateral për angazhime të pakthyeshme. Vlera e drejtë e këtyre depozitave përafrohet vlerën e mbetur.

Depozitat me klientët bartin interes të pandryshueshëm.

24 Detyrime të tjera

	<i>2013</i>	<i>2012</i>
Dividend të pagueshëm	87	90
Detyrime për transaksione në monedhë të huaj	172	21,662
Shpenzime të konstatuara	85,043	104,596
Detyrime të tjera	<u>242,207</u>	<u>261,095</u>
Detyrime të tjera financiare	327,509	387,443
Tatime të tjera për t'u paguar	2,787	3,369
Sigurime shoqërore për t'u paguar	15,794	8,748
	<u>346,090</u>	<u>399,560</u>
Afatshkurtër	346,090	399,560
Afatgjatë	-	-

Shpenzimet e konstatuara përfshijnë shpenzime mbi shërbime bazë, shpenzime telefoni dhe bonuse në lidhje me vitin aktual por që do të paguhen vitin në vazhdim.

25 Provigjione

	<i>2013</i>	<i>2012</i>
Më 1 janar	84,027	8,950
Fshirje	(61,173)	-
Shpenzime në fitim ose humbje	<u>157,102</u>	<u>75,077</u>
Më 31 dhjetor	<u>179,956</u>	<u>84,027</u>

Sipas legjislacionit tatimor shqiptar, autoritetet fiskale kanë të drejtë të inspektojnë deklarimet e tatimit për 5 vjet pas dorëzimit të tyre.

Ekziston një deklaram kundër autoriteteve tatimore. Kjo kërkesë bazohet në raportin e inspektimit të fundit tatimor lëshuar nga autoritetet tatimore gjatë vitit 2012. Inspektimi është realizuar për vitet financiare 2009-2011. Raporti i lëshuar në 31 tetor 2012 ka vlerësuar detyrimin shtesë të Bankes në lidhje me trajtimin e dispozitave nga zhvlerësimi me qëllim zbritjen e taksave (ALL 119,416 mijë) dhe nevojën për të ndaluar tatimin mbi transaksionet e shitjes ndërmjet akisionarëve (ALL 98,401 mijë).

Banka ka fituar rastin në tatimin në burim në ankesën e autoriteteve tatimore. Banka po ndjek rastin e zhvlerësimit të provigjionit në gjykatë. Banka ka ndryshuar provigjionin për rastin e një mashtrimi në shumën 61,173 mijë duke qenë se ai ishte rimbursuar pjesërisht (EUR 343,242 ose ALL 48,187 mijë) nga shoqëria e sigurimit. Një provigjion shtesë prej



25 Provigjone (vazhdim)

157,102 është regjistruar duke u bazuar në rekomandimet nga kontrolli i fundit i Bankes së Shqipërisë duke patur parasysh Bank Lending Rate (BLR), normë e përdorur gjerësisht në kreditë për konsumatorët. Bankës iu kërkua të ndryshonte të gjitha kontratat e kredive të cilave iu aplikojë më parë norma BLR dhe të ndryshojë me normën e interes të lëvizshme që derivon nga tregu i bonove të thesarit. Si pasojë, banka duhet të kthejë të ardhurat nga interesi shtesë të fituara gjatë vitit të kaluar kur BLR aplikojë, dhe gjithashtu duhet të ulë të ardhurat nga interes për të njëjtat rast gjatë vitit që u mbyll më 31 dhjetor 2013.

26 Kapitali i paguar dhe primi i aksioneve

	2013	2012
Kapitali i paguar i autorizuar, i emetuar dhe i paguar plotësisht	14,754,741	11,248,500
Primi i aksioneve	1,735,494	1,735,494

Tabela në vijim tregon strukturën e aksionerëve të bankës më 31 dhjetor 2013 dhe 2012.

Emri i aksionerit	Numri i aksioneve	Përqindje 31 dhjetor 2012	Numri i aksioneve	Përqindje 31 dhjetor 2011
	2012		2011	
Piraeus Bank S.A Greece	496,098	98,83	380,486	98,48
Mr. Tzivelis Ioannis	5,877	1.17	5,877	1,52
Totali	501,975	100,00	386,363	100,00

Më 31 dhjetor 2013, kapitali aksioner i bankës i autorizuar dhe i emetuar përbëhej nga 501,975 aksione me vlerë nominale 216,24 Euro (2012: 386,363 aksione me vlerë nominale 216,24 Euro) të gjitha të paguara.

Lëvizjet në kapitalin aksioner dhe primin e aksioneve janë si më poshtë:

	<i>Numri i aksioneve</i>	<i>Kapitali i paguar</i>	<i>Primi i aksioneve</i>
Më 1 janar 2012	386,363	11,248,500	1,735,494
Rritje nga kontributi i aksionerëve	-	-	-
Më 31 dhjetor 2012	386,363	11,248,500	1,735,494
Rritje nga kontributi i aksionerëve	115,612	3,506,241	-
Më 31 dhjetor 2012	501,975	14,754,741	1,735,494



27 Rezerva të tjera

Rezerva të tjera përbëhen si në vijim:

	2013			2012		
	Rezerva ligjore dhe të detyruara	Të disponueshme për shitje	Totali i rezervave të tjera	Rezerva ligjore dhe të detyruara	Të disponueshme për shitje	Totali i rezervave të tjera
Më 1 janar	1,389,948	103,968	1,493,916	1,389,948	52,336	1,442,284
Rivlerësimi i investimeve të disponueshme për shitje	-	176,455	176,455	-	57,307	57,307
Tatimi i shtyrë mbi rivlerësimin e investimeve të disponueshme për shitje	-	(29,264)	(29,264)	-	(5,675)	(5,675)
Transferim nga fitimi i mbartur	-	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor	1,389,948	251,159	1,641,107	1,389,948	103,968	1,493,916

Rezerva ligjore është përcaktuar në bazë të rregullores së Bankës së Shqipërisë “Për kapitalin fillestar minimal për aktivitetet e lejuara të bankave dhe degëve të licencuara të bankave të huaja”, nr. 51, datë 22 prill 1999. Bankat dhe degët e bankave të huaja do të krijojnë rezerva nga 1.25% deri në 2% të aktiveve të ponderuara me risk duke zbritur 1/5 e fitimit pas tatimit dhe para se të paguhet dividendët. Rezerva e detyruar është përcaktuar në bazë të nenit 39 të statutit të bankës i cili kërkon krijimin e rezervave duke mbajtur 5% të të ardhurave neto të bankës pas zbritjes së humbjeve të viteve të mëparshëm. Kjo procedurë nuk është e detyruar nëse rezerva arrin 1/10 e kapitalit të bankës.

Rezervat ligjore dhe të detyruara nuk mund të shpërndahen.

28 Dividendi

Asambleja e Përgjithshme e Aksionerëve ka vendosur që të mos shpërndajë dividendë nga fitimi i vitit 2012 dhe që ai fitim do të përdorej për rritjen e kapitalit të bankës. Nuk është marrë ende një vendim për fitimet e vitit 2013.

29 Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre

Me qëllim të pasqyrës së flukseve monetare, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen si në vijim:

	Nota	2013	2012
Arka	13	1,659,307	1,556,907
Llogari me Bankën Qendrore	13	3,786,283	233,083
Paraja në transit me bankat	13	-	362,934
Llogari rrjedhëse me bankat	13	2,919,248	4,885,557
Kredi dhe paradhënie për bankat	14	22,854,710	13,171,181
		31,219,548	20,209,662



30 Palët e lidhura

Gjatë kryerjes së biznesit bankar, banka kryen transaksione me palët e lidhura. Palët e lidhura përfshijnë (a) Piraeus Bank S.A Greqi për llogari rrjedhëse, vendosje ndërbankare dhe huamarrje, dhe (b) Tirana Leasing (degë e kompanisë prind) për kredi dhe depozita. Kompania prind e drejtpërdrejtë dhe përfundimtare e bankës është Piraeus Bank SA (Greqi).

Aktivi	2013	2012
Piraeus Bank SA Greqi		
Llogari rrjedhëse	53,313	62,460
Vendosje	15,098,916	8,371,241
REPO me Piraeus	7,007,096	-
Detyrime	(4,744)	(944)
Hua të marra	(2,131,603)	(1,350,576)
	<u>20,022,978</u>	<u>7,082,181</u>
Detyrime	2013	2012
Tirana Leasing (degë e Piraeus Bank SA)		
Kreditë e dhëna (Tirana Leasing)	677,772	65,494
Detyrime për Tirana Leasing	(3,874)	(6,360)
	<u>673,898</u>	<u>59,134</u>
Drejtorët e bankës		
Kredi të dhëna	35,835	33,413
Depozita	(74,817)	(3,077)
	<u>(38,982)</u>	<u>30,336</u>

Norma e interesit e aplikuar ndaj vendosjeve me Piraeus Bank për vitin 2013 ndryshojnë nga 0.4% në 3.95% (2012 nga 0.57% në 3.60%).

Për kreditë, normat e interesit për vitin 2013 ndryshojnë nga 2.10% në 3% (2012 nga 0.5% në 1.10%).

	2013	2012
Të ardhura dhe shpenzime		
Piraeus Bank S.A. Greqi		
Të ardhura nga interesi	250,647	173,736
Shpenzime të tjera	(34,042)	(25,064)
Të ardhura tarifat dhe komisionet	8	5
Shpenzime për tarifat dhe komisionet	(373)	(1,137)
	<u>216,240</u>	<u>147,540</u>
Tirana Leasing		
Të ardhura nga interesi	7,147	5,380
Shpenzime të tjera	-	-
	<u>7,147</u>	<u>5,380</u>



30 Palët e lidhura (vazhdim)

Shpërblime për menaxhimin kryesor

	2013	2012
Përfitime afatshkurtra		
Paga	26,182	43,421
Bonuse	2,962	2,641
	<u>29,144</u>	<u>46,062</u>

Në shpërblimet e menaxhimit kryesor përfshihen vetëm përfitimet afatshkurtra të punonjësve (pagat dhe bonuset). Përfitimet pas punësimit, pagesat e bazuara në aksione dhe përfitimet afatgjata nuk janë dhënë nga banka.

31 Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorive të matjes

Tabela në vijim paraqet një akordim të kategorive të aktiveve financiare sipas kategorive të matjes më 31 dhjetor 2013:

2013	Kredi dhe llogari të arkëtueshme	Të disponuesh me për shitje	Të mbajtura deri në maturim	Totali
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	15,812,560	-	-	15,812,560
Kredi dhe paradhënie për bankat	22,870,941	-	-	22,870,941
Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje	-	-	-	-
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	4,215,704	4,215,704
Aktive financiare të disponueshme për shitje		16,573,427		16,573,427
Kredi dhe paradhënie për klientët	38,643,915	-	-	38,643,915
Totali i aktiveve financiare	77,327,416	16,573,427	4,215,704	98,116,547
Aktive të tjera				3,262,674
Totali i aktivitetit				101,379,221



31 Paraqitja e instrumenteve financiare sipas kategorive të matjes (vazhdim)

2012	Kredi dhe llogari të arkëtueshme	Të disponuesh me për shitje	Të mbajtura deri në maturim	Totali
Mjete monetare dhe gjendje me Bankën Qendrore	13,866,273	-	-	13,866,273
Kredi dhe paradhënie për bankat	13,171,181	-	-	13,171,181
Aktive financiare të mbajtura me vlerë të drejtë në fitim ose humbje	-	-	-	-
Aktive financiare të mbajtura deri në maturim	-	-	4,718,685	4,718,685
Aktive financiare të disponueshme për shitje		12,211,401		12,211,401
Kredi dhe paradhënie për klientët	50,659,319	-	-	50,659,319
Aktive të tjera financiare	186,744	-	-	186,744
Totali i aktiveve financiare	77,696,773	12,211,401	4,718,685	94,626,859
Aktive të tjera				2,851,404
Totali i aktivitetit				97,478,263

Më 31 dhjetor 2013 dhe 2012, ndryshimet në vlerën e drejtë në investimet e mbajtura me vlerë të drejtë, shkojnë në fitim ose humbje të periudhës, investimet e vlefshme për shitje maten me vlerë të drejtë me ndryshime në pasqyrën e të ardhurave gjithpërfshirëse. Kreditë dhe llogaritë e tjera të arkëtueshme dhe investimet e mbajtura deri në maturim janë mbajtur me kosto të amortizuar.

Më 31 dhjetor 2013 dhe 31 dhjetor 2012, të gjitha detyrimet financiare të bankës janë mbajtur me kosto të amortizuar.

32 Ngjarje pas datës së raportimit

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit që do të kërkonin rregullime ose shënime shpjeguese shtesë në pasqyrat financiare.

Përkthyer nga: Elena Leri

REPUBLIKA E SHQIPERISE

NOTERIA

Nr. 26 Rep.


VERTETIM

Sot ne daten 24.07.2014, une notere Eriketa Kokoli notere ne Tirane une notere Eriketa Kokoli, notere ne Tirane , me Seli ne Rrugen " Sami Frasheri" Pallati i Ri, vertetova fimen e Elena Zeri, enjohur personalisht prej meje noteres te vene ne perkthimin nga gjuha anglisht ne shqip ne dokumentin : Pasqyrat Financiare 31 Dhjetor 2013.

Vertetimi i dokumentit u be ne baze te nenit 56 te Ligjes 7829 date 01.06.1994 " Per Noterine " (i ndryshuar) dhe udhezimit te Ministrit te Drejtesiose Nr.6291 date 17.09.2005.

NOTER

[Handwritten signature]



Tirana Bank sh.a.



Pasqyrat financiare më dhe për vitin e mbyllur më
31 dhjetor 2013